



Shpjegues për monitorimin e „gjuhës së urrejtjes“

Agjencia e Shërbimeve Mediatike Audio
dhe Audiovizive



Përmbajtja

1. Çelje
2. Liria e shprehjes
3. **Korniza rregullore evropiane për „gjuhën e urrejtjes“**
 - 3.1. Rekomandimi nr. R (97) 20 në lidhje me „gjuhën e urrejtjes“
 - 3.2. Rekomandimi nr. R (97) 21 për mediat dhe për promovimin e kulturës së tolerancës
 - 3.3. Deklarata për lirinë e debatit politik në media
 - 3.4. Rekomandimi CM/Rec(2011) 7 për koncept të ri për mediat
 - 3.5. Protokoli shtesë tek Konventa për „kriminalitetin kompjuterik“
4. **Qasja e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me „gjuhën e urrejtjes“**
5. **E drejta precedentale për „gjuhën e urrejtjes“ e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut**
 - 5.1. Hendisajd (Handyside) kundër Mbretërisë së Bashkuar
 - 5.2. Jersild kundër Danimarkës
 - 5.3. Muslum Gunduz kundër Turqisë
6. **Korniza rregullore maqedonase për „gjuhën e urrejtjes“**
 - 6.1. Ligji për shërbimet mediatike audio dhe audiovizive
 - 6.2. Kodi penal
 - 6.3. Ligji për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi
7. **Udhëzime për monitorimin e „gjuhës së urrejtjes“**
 - 7.1. Cili ka qenë konteksti i shprehjes?
 - 7.2. Kush është njeriu përgjegjës për shprehjen?
 - 7.3. A ka ekzistuar qëllimi për provokimin e gjuhës së urrejtjes?
 - 7.4. Cila është përmbajtja e shprehjes?
 - 7.5. Cilat kanë qenë shkalla dhe shtrirja e shprehjes?
 - 7.6. Sa ka qenë probabiliteti për të ndikuar ndaj publikut dhe veprimeve të tij të ardhshme?
8. **Shqyrtimi i praktikave të trupave të tjerë rregullatorë gjatë monitorimit të „gjuhës së urrejtjes“**
9. **Përfundime dhe rekomandime**

1. Çelje

Me miratimin e Direktivës për Shërbime Mediatike Audiovizive, Bashkimi Evropian ndërmori një varg aktiviteteve konkrete se si duhet vepruar në lidhje me gjuhën e urrejtjes në shërbimet mediatike audiovizive. Në nenin 6 të Direktivës është theksuar që pushtetet në çdo vend-anëtar „patjetër të kujdesen, me mjete gjegjëse, që shërbimet mediatike audiovizive të siguruara nga ana e dhënësve të shërbimeve mediatike nën kompetencën e tyre të mos përmbajnë kurrfarë nxitje të urrejtjes mbi bazë të racës, gjinisë, religjionit ose nacionalitetit.“

Krahas kësaj, në Direktivën për SHMAV është theksuar roli i trupave të pavarur rregullatorë në sferën audiovizive në realizimin e rregullativës ligjore nacionale, me të cilën barten rregullat nga Direktiva¹. Rregullatorët në sferën e shërbimeve mediatike audiovizive kanë kompetenca që të bëjnë mbikëqyrjen e harmonizimit të programeve audiovizive me Direktivën për SHMAV .

Në dhjetor të vitit 2013 Direktiva për Shërbime Mediatike Audiovizive ishte bartur në Ligjin e ri për shërbime mediatike audio dhe audiovizive të Republikës së Maqedonisë. Projekti „Forcimi i kapaciteteve administrative të trupave të ngarkuar për telekomunikacion dhe media për rregullim efikas të shërbimeve të reja digjitale dhe shumëfarëshe“, financuar nga ana e Komisionit Evropian sipas kornizës IPA, ka për qëllim që ta rritë kapacitetin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive (ASHMAAV) për realizimin e Direktivës për SHMAV. Njëri prej aktiviteteve më të rëndësishme në kuadër të projektit është shtimi i njohurisë dhe i kapacitetit të ASHMAAV-it për të vepruar në rastet e gjuhës së urrejtjes edhe në shërbimet mediatike audiovizive lineare dhe jolineare. Krahas stërvitjes për personelin e ASHMAAV-it, ekspertët e angazhuar në kuadër të Projektit e kishin për detyrë të përgatisnin Udhëzues për monitorimin e gjuhës së urrejtjes në shërbimet mediatike audiovizive.

Definicion universal për „gjuhën e urrejtjes “ nuk ka. Ka shumë udhëzime dhe shpjegime për atë se çka duhet të definohet si gjuhë e urrejtjes dhe çka duhet të përfshijë mbrojtja e lirisë së shprehjes. Në këtë dokument së pari janë paraqitur standardet ndërkombëtare në lidhje me lirinë e shprehjes dhe “gjuhën e urrejtjes” , parimet dhe rastet relevante të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe korniza juridike maqedonase nga ky aspekt. Në fund janë dhënë rekomandime për aspekte të ndryshme të cilat ASHMAAV duhet t'i marrë parasysh gjatë veprimit në rastet e mundshme të gjuhës së urrejtjes, si dhe përfundime rreth asaj se çka duhet të bëhet më tej që të përmirësohen kapacitetet dhe praktikat e Agjencisë.

¹ Shih më shumë detaje në: <http://ec.europa.eu/digital-agenda/en/avmsd-audiovisual-regulators>

2. Liria e shprehjes

Liria e shprehjes është njëra nga të drejtat themelore të njeriut dhe është bazë e shoqërisë demokratike bashkëkohore. Edhe pse është e mbrojtur me një numër të madh dokumentesh ndërkombëtare, vendet e kanë lirinë e definimit të fushës dhe të përmbajtjes së saj në rregullativat e tyre ligjore nacionale, varësisht nga dallimet e tyre kulturore, historike, fetare, politike dhe shumë të tjera.

Njëra prej marrëveshjeve të rëndësishme ndërkombëtare ku ligjërisht rregullohet liria e shprehjes pa dyshim është neni 19 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut,² ku është theksuar kjo në vazhdim:

„Secili ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes. Kjo e drejtë e përfshin edhe lirinë e mbështetjes së mendimit të caktuar pa kurrfarë përzierje dhe kërkimin, pranimin dhe transmetimin e informacioneve dhe ideve përmes mediave dhe pa përfillur kufijtë.“

Më tej, në nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut³ është shkruar si vijon:

„Secili ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë e përfshin edhe lirinë e mbështetjes së mendimit të caktuar dhe të pranimit dhe të dhënies së informacioneve dhe ideve pa përzierjen e pushtetit publik dhe pa përfillur kufijtë. Ky nen nuk i pengon shtetet që të kërkojnë licencimin e ndërmarrjeve të radiodifuzionit, të transmetimeve televizive apo të kinemave.“

„Realizimi i këtyre të drejtave, meqë me vete bart edhe obligime edhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet formaliteteve, kushteve, kufizimeve apo dënimeve të caktuara të cilat i parasheh ligji dhe janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë nacionale, integritetit territorial apo të sigurisë publike, për pengimin e trazirave a të kriminelitetit, për mbrojtjen e shëndetit apo të moralit, për mbrojtjen e reputacionit apo të të drejtave të të tjerëve, për pengimin e zbulimit të informacioneve të besueshme apo për ruajtjen e autoritetit dhe të paanësisë së gjyqësorit.“

Edhe pse të dyja marrëveshjet kanë datë mesin e shekullit të kaluar, të njëjtat ende aplikohen.

² Neni 19, Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut: http://ipa.mk/?page_id=120

³ Neni 10, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut:

http://www.google.com/url?sa=t&rct=j&q=&esrc=s&source=web&cd=1&ved=0CB8QFjAA&url=http%3A%2F%2Fwww.echr.coe.int%2FDocuments%2FConvention_MKD.pdf&ei=LSxvVL-9L8PMYgPPzoDYCg&usq=AFQjCNHOrNy0IYq62lcOjMC9AeaI9CeGWA&bvm=bv.80185997.d.bGQ

3. Korniza rregullatore evropiane për „gjuhën e urrejtjes“

Siç u tha më parë, nuk ka definicion universal për definicionin „gjuha e urrejtjes“. Domethënia e termit ka histori të gjatë në sistemet juridike të vendeve të ndryshme-anëtare të Këshillit të Evropës dhe të Bashkimit Evropian, bashkë me të drejtën precedentale të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (më tej në tekst „Gjyqit“).

Këshilli i Evropës ka krijuar definicione të ndryshme për „gjuhën e urrejtjes“ varësisht nga konteksti. Në këtë kaptinë do të paraqiten disa nga më të rëndësishmet.

3.1 Rekomandimi nr. R (97) 20 në lidhje me „gjuhën e urrejtjes“⁴

Në rekomandimin në lidhje me gjuhën e urrejtjes u rekomandohet qeverive të vendeve-anëtare që t'i ndërmarrin hapat e luftës kundër gjuhës së urrejtjes të përcaktuar në dokument. Kjo sidomos ka të bëjë me gjuhën e urrejtjes që përhapet përmes mediave.

Në Rekomandim bëhet përpjekje që të definohet termi „gjuhë e urrejtjes“ në këtë mënyrë:

Termi „gjuhë e urrejtjes“ do të kuptohet si term që i mbulon të gjitha format e shprehjes që përhapin, nxisin, promovojnë ose arsyetojnë urrejtje racore, ksenofobi, antisemitizëm apo forma të tjera të urrejtjes mbi bazë të mosdurimit, duke përfshirë: mosdurimin e shprehur përmes nacionalizmit dhe etnocentrizmit agresiv, diskriminimit dhe armiqësisë kundër pakicave, migrantëve dhe njerëzve me prejardhje imigrante.

Më tej, Rekomandimi sidomos i fton qeveritë e vendeve-anëtare që të përcaktojnë që pushtetet publike dhe institucionet publike në nivel nacional, rajonal dhe lokal, si dhe nëpunësit e tyre të kenë përgjegjësi të veçantë dhe të përmbahen nga deklaratat, sidomos para mediave, të cilat me arsye mund të kuptohen si gjuhë e urrejtjes, ose si gjuhë e cila do të mund të krijonte efektin e ligjësimin, përhapjes apo promovimit të urrejtjes racore, të ksenofobisë, antisemitizmit apo të formave të tjera të diskriminimit a të urrejtjes mbi bazë të mosdurimit. Deklaratat e tilla duhet të ndalohen dhe publikisht të hidhen sa herë kur do të paraqiten.

Rekomandimi i fton qeveritë të ngrenë ose të ruajnë kornizën e fortë juridike në të drejtën civile, penale dhe administrative që përbëhet nga dispozita për gjuhën e urrejtjes, që do t'u mundësojë pushteteve administrative ose gjyqësore që të vendosin që në çdo rast të respektohet liria e shprehjes dhe dinjiteti i njeriut, dhe të mbrohen reputacioni ose të drejtat e të tjerëve.

⁴ Rekomandimi No. R (97) 20 në lidhje me „gjuhën e urrejtjes“, miratuar nga ana e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës më 30 tetor 1997, tek i cili arrihet në: http://www.avmu.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=1734%3A-r97-20-g&catid=50%3Aevropska-legislative-cat&Itemid=339&lang=mk

Gjithashtu, nga qeveritë kërkohet që t'i hulumtojnë mënyrat dhe mjetet për stimulimin dhe koordinimin e hulumtimit të efekteve të rregullativës ligjore ekzistuese dhe të praktikës juridike; shikimin e kornizës juridike ekzistuese, me qëllim që të sigurohen se e njëjta aplikohet në mënyrë gjegjëse tek shërbimet dhe rrjetet e ndryshme të reja të medias dhe të komunikimit; për zhvillimin e politikës së koordinuar të prokurorisë mbi bazë të udhëzimeve nacionale, me respektimin e parimeve të përcaktuara në këtë Rekomandim; për të shtuar urdhëresat që përfshijnë punën me leverdi të përgjithshme shoqërore në sferën e sanksioneve të mundshme ndëshkimore; për forcimin e mundësive të luftës kundër gjuhës së urrejtjes përmes të drejtës civile⁵, dhe për sigurimin e informacioneve për publikun dhe për profesionistët e medias rreth dispozitave juridike që vlejnë për gjuhën e urrejtjes.

Gjithashtu, qeveritë duhet të sigurohen që në kuadrin e tyre juridik, përzierja në lirinë e shprehjes është rumbullakuar dhe aplikuar ngushtë, në mënyrë ligjore dhe joarbitrare, mbi bazë të kriterëve objektive. Më tej, konform kërkesës themelore për sundimin e së drejtës, çdo kufizim ose përzierje në lirinë e shprehjes patjetër t'i nënshtrohet kontrollit të pavarur gjyqësor. Kjo kërkesë është sidomos e rëndësishme në rastet kur liria e shprehjes e ka patjetër që të harmonizohet me respektimin e dinjitetit të njeriut dhe mbrojtjen e reputacionit ose të të drejtave të të tjerëve.

E drejta dhe praktika nacionale duhet t'u mundësojnë gjyqeve që të kenë parasysh se raste të caktuara të gjuhës së urrejtjes mund të jenë aq ofenduese për individë ose grupe, sa të njëjtat të mos e gëzojnë nivelin e mbrojtjes së siguruar me nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për forma të tjera të shprehjes. Kjo ndodh kur gjuha e urrejtjes është e drejtuar kah shkatërimi i të drejtave dhe lirive të theksuara në Konventë ose kah kufizimi i tyre në një shkallë më të lartë nga ajo që është siguruar në të.

Me Parimin 5 nga Rekomandimi kërkohet që me ligjet dhe praktikat nacionale t'u mundësohet trupave kompetente të prokurorisë që t'i kushtojnë kujdes të veçantë, aq sa ua lejon liria e tyre e vendosjes, rasteve që përfshijnë gjuhën e urrejtjes. Nga ky aspekt, këto pushtete duhet t'i kushtojnë vëmendje, sidomos, të drejtës së lirisë së shprehjes të të dyshuarit, për shkak të faktit se imponimi i sanksioneve penale zakonisht paraqet përzierje serioze në lirinë e tillë. Gjyqet kompetente duhet që, gjatë imponimit të sanksioneve penale personave të dënuar për vepra të gjuhës së urrejtjes, të sigurojnë respektimin e rreptë të parimit të proporcionalitetit.

E drejta dhe praktika nacionale në sferën e gjuhës së urrejtjes duhet të ndërmarrin masa adekuate në lidhje me rolin e mediave në bartjen e informacioneve dhe ideve që nxjerrin, analizojnë dhe shpjegojnë raste konkrete të gjuhës së urrejtjes dhe fenomenin relevant nga aspekti i përgjithshëm, si dhe të drejtës që opinioni publik t'i marrë informatat dhe idetë e tilla.

⁵ Për shembull, ashtu që do t'u mundësojë organizatave joqeveritare të interesuara që të ngrenë aktpadi civile, për sigurimin e kompensimit për viktimat e gjuhës së urrejtjes dhe sigurimin e mundësisë për urdhëresa gjyqësore të cilat viktimave u mundësojnë të drejtën e përgjigjes ose urdhëresa për t'u tërhequr.

Njëri prej dallimeve më të rëndësishme, që duhet të jetë i shprehur qartë në të drejtën dhe praktikën nacionale, është që të bëhet dallim i qartë ndërmjet përgjegjësisë së autorit për shprehjet e gjuhës së urrejtjes, nga njëra anë, dhe njëfarë përgjegjësie të mediave dhe të ekspertëve të mediave që kontribuojnë në përhapjen e të njëjtave, si pjesë e misionit të tyre për të bartur informacione dhe ide për çështje me interes publik, nga ana tjetër.

Parimi i rëndësishëm që është theksuar me Rekomandim është se ligjet dhe praktikat nacionale duhet të kenë parasysh se raportimi për racizmin, ksenofobinë, antisemitizmin dhe format tjera të mosdurimit tërësisht është i mbrojtur me nenin 10, paragrafi 1, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe mund të pengohet vetëm sipas kushteve të përcaktuara në paragrafin 2 të kësaj dispozite⁶. Më tej, **standardet që aplikojnë pushtetet nacionale në vlerësimin e nevojës për kufizimin e lirisë së shprehjes patjetër të jenë në pajtim me parimet e nenit 10, siç është përcaktuar në të drejtën precedentale në trupat e Konventës, duke pasur parasysh, veç tjerash, mënyrën, përmbajtjen, kontekstin dhe qëllimin e raportimit.** Dhe në fund, respektimi i lirive gazetareske gjithashtu implikon që nuk janë gjyqet ose pushtetet publike ato që do të duhet t'i imponojnë pikëpamjet e tyre ndaj mediave në lidhje me teknikat për raportim, por vetë gazetarët, të cilat ata i aplikojnë.

3.2 Rekomandimi nr. R (97) 21 për mediat dhe për promovimin e kulturës së tolerancës⁷

Ky Rekomandim kërkon nga qeveritë e vendeve-anëtare që t'i informojnë grupet e targetuara në vazhdim për përmbajtjen e Rekomandimit dhe të Shtojcës së tij me qëllim që ato të realizohen, si dhe që të shqyrtohet nga aspekti pozitiv çdo kërkesë për mbështetjen e iniciativave që dalin nga ky dokument. Grupet e targetuara (synore) janë këto në vazhdim:

- shtypi, radioja dhe televizioni, si dhe sektorët e rinj të komunikimeve dhe të reklamave;
- trupat që përfaqësojnë profesionistët e mediave në këta sektorë;
- trupat rregullatorë dhe vetë-rregullatorë në këta sektorë;
- shkollat për gazetari dhe institutet për stërvitjen e mediave.

⁶ Kur këtë e thotë ligji, kur ka një objektiv legjitim dhe kur është e nevojshme në shoqërinë demokratike.

⁷ Rekomandimi nr. R (97) 21 për mediat dhe promovimin e kulturës së tolerancës, miratuar nga Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës më 30 tetor 1997, mund të shihet në: http://www.avmu.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=1735%3A-r-97-21-&catid=50%3Aevropska-legislative-cat&Itemid=339&lang=mk

3.3 Deklarata për lirinë e debatit politik në media⁸

Kjo Deklaratë u kushton vëmendje të veçantë këtyre parimeve në lidhje me përhapjen e informacioneve dhe mendimeve në media për figurat politike dhe nëpunësit publik:

I. Liria e shprehjes dhe e informimit përmes mediave

Demokracia pluraliste dhe liria e debatit politik kërkojnë që publiku të jetë i informuar për çështje të interesit publik, të cilat e përfshijnë të drejtën e mediave për diseminacion (shpërndarje) të informacioneve negative dhe mendimeve kritike në lidhje me figurat politike dhe nëpunësit publik, si dhe të drejtën e publikut për t'i pranuar këto informacione.

II. Liria për të kritikuar institucionet shtetërore ose publike

Shteti, qeveria ose cilido qoftë prej institucioneve nga sfera ekzekutive, legislative apo gjyqësore mund t'u nënshtrohen kritikave në media. Për shkak të pozitës së tyre dominante, këto institucione, si të tilla, nuk duhet të jenë të mbrojtura me Kodin penal në lidhje me deklarata të shpifjes ose të ofendimit. Megjithatë, aty ku këto institucione e gëzojnë mbrojtjen e tillë, kjo mbrojtje duhet të aplikohet në mënyrë kufizuese, dhe në të gjitha rrethanat duhet t'i iket aplikimit të saj për kufizimin e të drejtës për kritikë. Individët që i përfaqësojnë këto institucione mbeten të mbrojtur si individë.

III. Debatit publik dhe mbikëqyrja ndaj figurave politike

Figurat politike kanë vendosur që ta kërkojnë besimin e publikut dhe kanë pranuar që t'i nënshtrohen debatit politik publik, e me këtë edhe mbikëqyrjes së afërt të publikut dhe, potencialisht, kritikave të mëdha e të forta publike përmes mediave në lidhje me mënyrën se si i kryejnë funksionet e tyre.

⁸ Deklaratë për lirinë e debatit politik në media miratuar nga Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës më 12 shkurt 2004. Mund të shihet në: http://www.avmu.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=141%3Adeklaracija-za-slobodata-na-politickata-debata-vo-mediumite&catid=50%3Aevropska-legislative-cat&Itemid=339&lang=mk

IV. Mbikëqyrja nga ana e publikut në lidhje me nëpunësit publikë

Nëpunësit publikë e kanë patjetër të pranojnë se do t'i nënshtrohen mbikëqyrjes dhe kritikës publike, sidomos përmes mediave, në lidhje me atë se si i kryejnë funksionet e tyre, gjithnjë derisa kjo është e nevojshme që të sigurohet transparenca dhe kryerja me përgjegjësi e funksioneve të tyre.

V. Liria për satirë

Zhanri humoristik dhe satirik, në pajtim me mbrojtjen nga neni 10 i Konventës, lejon një shkallë më të gjerë zmadhimi, bile dhe provokimi, gjithnjë derisa publiku nuk është orientuar gabimisht në lidhje me faktet.

VI. Reputacioni i figurave politike dhe nëpunësve publikë

Figurat politike nuk duhet të gëzojnë mbrojtje më të madhe të reputacionit dhe të të drejtave të tjera në krahasim me individët tjerë, për të cilën gjë nuk duhet të shqiptohen sanksione më të rrepta sipas të drejtës vendore kundër mediave kur ato i kritikojnë figurat politike. Ky parim, gjithashtu, vlen edhe për nëpunësit publikë – lëshimet janë të lejueshme vetëm kur ato janë rreptësisht të nevojshme që nëpunësve publikë t'u mundësohet që t'i kryejnë funksionet e tyre në mënyrë adekuate.

VII. Privatësia e figurave politike dhe e nëpunësve publikë

Jeta private dhe jeta familjare e figurave politike dhe e nëpunësve publikë duhet të jenë të mbrojtura në lidhje me raportimin mediatik sipas nenit 8 të Konventës. Megjithatë, informacionet në lidhje me jetën e tyre private mund të kenë diseminacion kur bëhet fjalë për brengosje direkte publike për mënyrën se si i kanë kryer apo si i kryejnë funksionet e tyre, duke pasur me këtë rast parasysh nevojën e shmangies së lëndimit të panevojshëm të palëve të treta. Kur figurat politike dhe nëpunësit publikë e kthejnë vëmendjen e publikut kah pjesët e jetës së tyre private, mediat kanë të drejtë që këto pjesë t'i nxjerrin në mbikëqyrje.

VIII. Masa korrektuese në lidhje me shkeljet nga ana e mediave

Figurat politike dhe nëpunësit publikë duhet të kenë qasje vetëm tek ato mjete juridike kundër mediave të cilat i kanë edhe personat privat në rastin e shkeljes së të drejtave të tyre nga ana e mediave. Dëmshtëpërblimet dhe dënimet për shpifje apo ofendim patjetër të jenë në përpjesëtim të arsyeshëm me shkeljet e të drejtave apo të reputacionit të të tjerëve, duke i marrë parasysh të gjitha masat korrektuese vullnetare të mundshme, efektive dhe gjegjëse, që janë dhënë nga mediat dhe janë të pranuar nga ana e personave të prekur. Shpifja ose ofendimi nga ana e mediave nuk duhet të rezultojnë me dënim me burg, përveç nëse shkak i seriozitetit të shkeljes së të drejtave apo të reputacionit të të tjerëve nuk është rreptësisht i nevojshëm dhe proporcional, sidomos kur ka shkelje serioze të të drejtave të tjera themelore përmes deklaratave për shpifje apo ofendim në media, siç është gjuha e urrejtjes.

3.4 Rekomandimi CM/Rec(2011) 7 për koncept të ri për mediat⁹

Në këtë Rekomandim është dhënë ky tregues në vazhdim për gjuhën e urrejtjes:

„Mediat duhet të përmbahen nga mbartja e gjuhës së urrejtjes dhe e përmbajtjes tjetër që nxit dhunë ose diskriminim nga cilado qoftë arsye. Nevojitet një kujdes i veçantë në lidhje me subjektet që punojnë me hapësira kolektive me përndarje on-line, të cilat janë të disenjuara që ta lehtësojnë komunikimin masiv interaktiv (apo komunikimin masiv nga aspekti i përgjithshëm). Ato duhet të bëjnë kujdes edhe gjatë përdorimit dhe gjatë përgjigjes së redaksisë për shprehje me paragjykime raciste, ksenofobike, antisemitistike, mizogonike, seksistike e të tjera. Nga pjesëmarrësit në ekosistemin e ri mediatik mund të kërkohet (me ligj) që t'i paraqesin tek pushtetet kompetente kërcënimet kriminale për dhunë mbi bazë racore, etnike, fetare, gjinore ose mbi bazë tjetër për të cilën do të kuptojnë.“

Nga ana tjetër, mediat mund të sigurojnë pamje të balancuar (ose pozitive) për grupet e ndryshme që e përbëjnë shoqërinë dhe t'i kontribuojnë kulturës së tolerancës dhe të dialogut. Përveç në rastet që i parasheh ligji me respektimin e dispozitave të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, asnjë grup në shoqëri nuk duhet të jetë i diskriminuar në lidhje me aplikimin e të drejtës për bashkim, e cila, në ekosistemin e ri mediatik, përfshin bashkimin on-line.

3.5 Protokollin shtesë tek Konventa për „kriminalitetin kompjuterik“¹⁰

Në Protokollin shtesë tek Konventa ka një definicion të rëndësishëm për “materialin racist dhe ksenofobik”, që thotë:

„Për nevojat e këtij Protokollin, “material racist dhe ksenofobik” do të thotë çfarëdo materiali i shkruar, çfarëdo figure apo çfarëdo paraqitje tjetër e ideve apo teorive, me të cilat paraqitet, promovohet ose nxitet urrejtje, diskriminim ose dhunë kundër cilitdo individ, ose grupe individësh, mbi bazë të racës, ngjyrës, prejardhjes apo përkatësisë nacionale ose etnike, si dhe të religjionit, nëse shfrytëzohet si arsyetim për cilindo prej këtyre faktorëve.“

⁹ Rekomandimi CM/Rec(2011)7 i Komitetit të Ministrave për vendet-anëtare për konceptin e ri për media, miratuar më 21 shtator 2011, mund të shihet në: http://www.avmu.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=1226%3A-cmrec20117-&catid=50%3Aevropska-legislative-cat&Itemid=339&lang=mk

¹⁰ Protokollin shtesë tek Konventa për kriminalitetin kompjuterik, në lidhje me kriminalizimin e veprave të natyrës raciste dhe ksenofobike të kryera përmes sistemeve kompjuterike, CETS No.: 189, mund të shihet në: <http://www.conventions.coe.int/treaty/EN/treaties/html/189.htm>

4. Qasja e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me „gjuhën e urrejtjes“

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut është formuar në Strazburg në vitin 1959 nga ana e vendeve-anëtare të Këshillit të Evropës me objektiv veprimin në lidhje me shkeljet e pretenduara të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. I njëjti merr vendime sidomos mbi bazë të nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut¹¹ dhe të testit trepartiak për atë se kufizimi i lirisë së shprehjes a është i aktuar me ligj, a është me objektiv legjitim dhe a është i nevojshëm në shoqërinë demokratike.

Gjyqit mund t'i drejtohet çdo person privat ose organizatë, që konsiderojnë se të drejtat e tyre të njeriut janë shkelur nga ana e shtetit. Megjithatë, më parë duhet të shteren të gjitha mjetet juridike nacionale, kërkesa duhet të dorëzohet në afat prej gjashtë muajsh pas marrjes së vendimit përfundimtar, ndërsa shkelja duhet të jetë bërë nga ana e pushteteve publike¹².

Edhe pse rruga deri te Gjyqi ndonjëherë është shumë e gjatë, dhe mund të kalojnë shumë vite nga momenti i shkeljes së të drejtave të njeriut deri në dorëzimin e kërkesës drejtuar Gjyqit, megjithatë ia vlen të aplikohet. Vendimi i Gjyqit është obligator për shtetin e përfshirë në lëndë, ndërsa ai që do ta fitojë rastin ka të drejtën e kompensimit të harxhimeve dhe të shpenzimeve. Komiteti i Ministrave është përgjegjës për të pohuar se shteti a i ka ndërmarrë masat gjegjëse korrektuese për të përmbushur obligimet e aktvendimit. Shumë shpesh, efekte shoqëruese të vendimit të Gjyqit janë modifikimi i legjislacionit nacional, zhvillimi i sistemit juridik dhe ndryshimi i politikës së ndjekjes.

Gjyqi ka detyrë mjaft të rëndë çdoherë kur bën matjen se a ka pasur „gjuhë të urrejtjes“ në rastin konkret. Për këtë shkak, me kalimin e kohës, Gjyqi i ka formuluar tri përgjigjet më të shpeshta kur është në pyetje „gjuha e urrejtjes“:

- Gjuha e urrejtjes mund të arsyetohet duke i shkuar kontekstit,
- Gjuha e urrejtjes nuk mund të arsyetohet,

¹¹ “Çdokush ka të drejtën e shprehjes. Kjo e drejtë përfshin edhe lirinë e mbështetjes së ndonjë mendimi dhe të pranimit e të transmetimit të informacioneve dhe ideve pa përzjerjen e pushtetit publik dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i pengon shtetet që të kërkojnë licencimin e ndërmarrjeve për radiodifuzion, për transmetim televiziv apo për kinema.

Realizimi i këtyre lirive, meqë me vete bart edhe obligime edhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet formaliteve, kushteve, kufizimeve ose dënimeve të caktuara që janë të parapara me ligj dhe që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë nacionale, integritetit territorial ose të sigurisë publike, për pengimin e trazirave dhe të kriminalitetit, për mbrojtjen e shëndetit ose të vlerave morale, për mbrojtjen e reputacionit ose të të drejtave të të tjerëve, për pengimin e zbulimit të informacioneve të besueshme ose për ruajtjen e autoritetit dhe të paanshmërisë së gjyqësisë.”

¹² Si të dorëzohet kërkesa valide? Shih: <http://www.echr.coe.int/Pages/home.aspx?p=applicants> (arritur më 25 shtator 2014).

- Mungesë e tërësishme e gjuhës së urrejtjes¹³.

Gjatë caktimit të gjuhës së urrejtjes, Gjyqi vlerëson disa aspekte të ndryshme. Aspekti i parë ka të bëjë me balancin ndërmjet kontekstit të shprehjes dhe përmbajtjes së saj. Krahas kësaj, Gjyqi e vlerëson funksionin e bartësit të kërkesës dhe rolin e tij/të saj në shoqëri, ku është bërë shprehja, në cilën formë. Disa prej gjykatësve të Gjyqit haptas i japin më shumë rëndësi kontekstit së përmbajtjes kur e caktojnë „gjuhën e urrejtjes“¹⁴. Megjithatë, në të gjitha rastet GJEDNJ sugjeron se **përhapja e gjuhës së urrejtjes me përdorim të mass-mediave mund të jetë më problematike**¹⁵ sesa gjuha e urrejtjes në poezi, libra, postera, broshura etj.

Kur bëhet fjalë për diferencimin midis politikanit dhe personit privat, Gjyqi është me qëndrim se „kufijtë e kritikës së pranueshme janë më të gjerë kur objektivi është politikani sesa kur punohet për personin privat“¹⁶. Për këtë shkak, politikanët duhet të tregojnë shkallë më të lartë tolerance për kritikën që i marrin nga gazetarët dhe nga publiku i përgjithshëm.

Qëndrimi i Gjyqit në lidhje me rastet e „gjuhës së urrejtjes“ që përfshijnë ndjenja fetare është ky në vazhdim: *„ata që do të vendosin që ta shfrytëzojnë lirinë për manifestimin e religjionit të tyre, pa marrë parasysh atë se të njëjtën e bëjnë si pjesëtarë të shumicës apo të pakicës fetare, nuk mund të presin arsyeshëm se do të çlirohen nga çdo kritikë! Ata e kanë patjetër ta tolerojnë dhe ta pranojnë mohimin nga ana e të tjerëve të bindjes së tyre fetare, bile dhe propagimin nga ana e të tjerëve të doktrinave që janë në kundërshtim me fenë e tyre“*. Në më shumë aktvendime, Gjyqi ka vendosur që „nuk ka shkelje të nenit 10“ dhe ka konsideruar se kufizimi i lirisë së shprehjes nga ana e shtetit të përfshirë në lëndë ka qenë e nevojshme për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve. Në rastet tjera, GJEDNJ ka dalë me përcaktimin se nuk ka shkelje të lirisë së shprehjes dhe ka pranuar se shprehje të caktuara, të cilat ndoshta kanë qenë „shokante“ ose „ofenduese“, nuk duhet të jenë të kufizuara gjithnjë derisa panevojshëm nuk janë ofenduese, toni ofendues nuk është direkt i drejtuar kah besimtarë konkret, shprehja nuk është ofenduese as për besimtarët as në lidhje me simbolet e shenjta, nuk i kanë shkelur të drejtat e besimtarëve për të manifestuar ose praktikuar religjionin e tyre dhe s’e kanë degraduar fenë e tyre dhe konkretisht, të njëjtët nuk kanë nxitur mosrespektim, urrejtje ose dhunë.

Gjyqi ka vendosur që kufizimet e lirisë së shprehjes janë të pranueshme vetëm „nëse janë përgjigje ndaj ‘nevojës së pashmangshme shoqërore’“, dhe nëse mjetet e përdorura janë në përpjesëtim me objektivin e paraparë legjitim. Megjithatë, ka konstatuar se këtu pushtetet nacionale gëzojnë një lloj „të drejte diskrecioni“, e cila varion nga rasti në rast dhe të cilën GJEDNJ në çdo rast do ta mbikëqyrë. Gjithashtu, GJEDNJ ka përcaktuar se neni 10 vlen jo vetëm për „informacionet“ ose „idetë“ të cilat

¹³ Shih më shumë detaje: Mario Oitheimer, Protecting Freedom of Expression: “The Challenge of Hate Speech in the European Court of Human Rights Case Law”, Cardozo Journal of International & Comparative Law, 9 nëntor 2009, faqe 8.

¹⁴ Ibid, faqe 15.

¹⁵ Ibid, faqe 14.

¹⁶ Këshilli i Evropës, Doracak në lidhje me gjuhën e urrejtjes, Listë faktesh, Këshilli i Evropës, nëntor 2008, fq. 4.

pranohen përshtatshëm ose nuk konsiderohen si ofenduese ose, ndërkaq, konsiderohen si indiferente, por edhe për "ato që e ofendojnë, e shokojnë ose e shqetësojnë shtetin ose cilëndo pjesë të popullsisë"¹⁷.

Një tjetër fakt të cilin Gjyqi seriozisht e merr parasysh është ai se „gjuha e urrejtjes“ a është thënë gjatë programit të drejtpërdrejtë. Gjyqi sidomos shqyrton se autori a ka pasur shans që ta korrigojë gjuhën që ka përdorur. Për këtë shkak, në rast të deklaratave verbale të dhëna gjatë TV-debatit të drejtpërdrejtë, Gjyqi thekson se dorëzuesi i kërkesës nuk ka pasur mundësi që t'i „riformulojë, . . . , t'i pastrojë ose. . . t'i tërheqë të njëjtat para se t'i shkojnë publikut¹⁸. Ky format debati e lejon „shkëmbimin e mendimeve, bile dhe fjalosjen në atë mënyrë që mendimet e shprehura krijojnë baraspeshë të ndërsjellë, ndërsa debati e ruan vëmendjen e shikuesve¹⁹. Gjykatësit e Gjyqit gjithnjë e kanë parasysh se ka rrezik që mediat të „bëhen mjet diseminacioni të gjuhës së urrejtjes dhe të promovimit të dhunës“²⁰.

¹⁷ Ibid, fq. 3.

¹⁸ Shih më shumë në: Mario Oitheimer, Protecting Freedom of Expression: “The Challenge of Hate Speech in the European Court of Human Rights Case Law”, Cardozo Journal of International & Comparative Law , 9 nëntor 2009, fq. 14.

¹⁹ Ibid.

²⁰ Për më shumë, shih në rastin Surek dhe Ozdemir kundër Turqisë.

5. E drejta precedente për „gjuhën e urrejtjes“ e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Republika e Maqedonisë e ratifikoi Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në vitin 1997, duke pranuar kështu jo vetëm zbatimin e Konventës, por edhe të drejtës precedente të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Më tej, neni 48 i Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizive, paragrafi 2, përcakton që „ndalesat e veçanta nga paragrafi (1) i këtij neni do të jenë **në pajtim me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut**“. Për këtë shkak, këtu do të paraqiten disa prej rasteve të cilat e përbëjnë themelin e sistemit juridik të Gjyqit, ndërsa të gjitha rastet tjera janë të arritshme në ueb-faqen e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe në më shumë publikacione me vendimet më të rëndësishme dhe më të ndikueshme²¹.

5.1 Hendisajd (Handyside) kundër Mbretërisë së Bashkuar

Në aktvendimin për rastin Hendisajd kundër Mbretërisë së Bashkuar, Gjyqi përcaktoi që ndalesa e imponuar nga ana e pushteteve britanike sipas Ligjit për publikacione të pahijshme ndaj librit me titull *Libër shkollor kuqosh i vogël (Little Red School Book)* është në pajtim me përjashtimin e përcaktuar në nenin 10, paragrafi 2, në lidhje me mbrojtjen e moralit. Gjyqi më tej e theksoi rëndësinë e lirisë së shprehjes në një shoqëri demokratike, duke nënvizuar:

„Liria e shprehjes përbën njërin prej bazave kyç të shoqërisë së tillë, njërin prej kushteve bazë për përparimin e saj dhe për zhvillimin e secilit njeri. Sipas nenit 10, paragrafi 2, ajo aplikohet jo vetëm për ‘informacionet’ ose ‘idetë’ që pranohen përshtatshëm apo që konsiderohen si joofenduese ose indiferente, por edhe për ato që e ofendojnë, e shokojnë ose e shqetësojnë shtetin ose ndonjë pjesë të popullsisë. Të tilla janë kërkesat e pluralizmit, tolerancës dhe të kuptimit të gjerë dhe pa to nuk ka shoqëri demokratike“.

Ky është rasti më i cituar gjer më sot, dhe në të Gjyqi për herë të parë e thekson rolin fundamental të lirisë së shprehjes në të gjitha shoqëritë demokratike, duke theksuar se liria e shprehjes është „njëri prej themeleve kyç“ të shoqërisë demokratike. Gjithashtu, Gjyqi theksoi se ajo liri „përbën...njërin prej kushteve bazë të përparimit të saj dhe të zhvillimit të secilit njeri“. Kjo qasje shoqërohet nga niveli i lartë i mbrojtjes së “informacioneve” ose “ideve” të cilat pranohen përshtatshëm ose konsiderohen si joofenduese ose indiferente, si dhe për ato që e ofendojnë, e shokojnë ose e shqetësojnë shtetin ose ndonjë pjesë të popullsisë“.

Me aktvendimin për Hendisajd kundër Mbretërisë së Bashkuar definitivisht u vu guri themeltar për mbrojtjen e gjuhës politike, e cila definohet si gjuhë „e cila dukshëm kontribuon në shkëmbimin e informacioneve dhe ideve në një shoqëri demokratike“, dhe ka mbrojtje të fortë nga Gjyqi. Për këtë shkak,

²¹ Si, për shembull: Freedom of Expression in Europe, Case-law concerning Article 10 of the European Convention on Human Rights, Human Rights file No. 18, Council of Europe Publishing, mars 2007.

Gjyqi së shpejti do të pranojë kufizime të cilat imponohen ndaj llojeve të tjera të gjuhës sesa kufijtë/kufizimet e gjuhës politike.

5.2 Jersild kundër Danimarkës

Dorëzuesi i kërkesës, gazetar, ka bërë film dokumentar me pjesë nga intervista televizive të cilën e ka zhvilluar me tre anëtarë të grupit të të rinjve që veten e quajnë “Xhaketa të gjelbra” („Greenjackets“), dhe të cilët janë deklaruar me vërejtje ofenduese dhe nënshtruese për imigrantët dhe grupet etnike në Danimarkë. Dorëzuesi është akuzuar se ka ndihmuar dhe ka nxitur në përhapjen e vërejtjeve raciste. Ai ka pohuar se ka shkelje të të drejtës së tij në lirinë e shprehjes.

Gjyqi ka bërë dallimin ndërmjet anëtarëve të grupit „Greenjackets“, të cilët kanë dhënë vërejtje të hapura raciste, dhe zotit Jersild, që ka dashur ta paraqesë, ta analizojë dhe të japë shpjegime për këtë grup konkret të rinjsh dhe t'i shqyrtojë „aspektet e veçanta të çështjes, e cila tashmë ka qenë lëndë e brengosjes së madhe publike“. Filmi dokumentar, si tërësi, nuk ka pasur për qëllim që të propagojë mendime dhe ide raciste, por ta informojë publikun për një çështje shoqërore. Rrjedhimisht, Gjyqi erdhi në përfundim se ka **shkelje të nenit 10** (liria e shprehjes).

5.3 Muslum Gunduz kundër Turqisë

Në këtë rast ishte iniciuar procedurë penale kundër zotit Gunduz pas paraqitjes së tij, në cilësinë e liderit të Tarikatit Axhzmendi (*Tarikat Aczmendi*) (bashkësi e cila veten e përshkruan si sektë islamistike), në programin televiziv të emetuar nga kanali *HBB*. Programi është emetuar drejtpërdrejt më 12 qershor 1995 dhe ka zgjatur afërsisht katër orë. Më 1 prill 1996 Gjykata Shtetërore e Sigurisë vendosi që ai është fajtor për nxitjen e njerëzve në urrejtje dhe armiqësi mbi bazë të dallimit me mbështetje në religjion, dhe e dënoi me dy vjet burg dhe me të holla.

Gjyqi përcaktoi se ai i kishte përshkruar institucionet bashkëkohore shekulare si “të pazot”, i ka kritikuar parimet shekulare dhe demokratike, haptas ka bërë thirrje për instalimin e shariatit. Zoti Gunduz i kishte drejtuar ankesë GJEDNJ-së, duke theksuar se vendimi penal kundër tij e shkel nenin 10 të Konventës.

Gjyqi konstatoi se shpallja e dorëzuesit të kërkesës si fajtor përbën përzierje në të drejtën e tij të shprehjes. Përzierja e tillë ishte **rregulluar me Kodin penal turk, dhe e njëjta ka pasur objektiv legjitim** – të pengojë mungesën e rendit apo krimin dhe të mbrojë moralin dhe të drejtat e të tjerëve.

„Gjuha e urrejtjes“ e kësaj lënde ishte deklaruar në program të drejtpëdrejtë dhe i është referuar sektës, pasuesit e së cilës e kishin tërhequr vëmendjen e opinionit publik. Zoti Gunduz, me idetë e të cilit publiku tashmë kishte qenë i njoftuar, ishte ftuar në program për të paraqitur sektën dhe pikëpamjet e saj jokonformistike, përfshi dhe mendimin se vlerat demokratike janë jokompatible me konceptin e Islamit. Tema ishte lëndë e një debati të gjerë në mediat turke dhe përbënte problem me interes të gjerë. Një pjesë

e **komenteve**, për të cilat gjykatat vendore e kishin gjykuar dorëzuesin e kërkesës, me të vërtetë tregonin se ai ka qëndrim të pakompromistë, dhe pakënaqësi të thellë, ndaj institucioneve bashkëkohore në Turqi. Megjithatë, ato **nuk mund** të llogariten si thirrje për dhunë ose për „**gjuhë të urrejtjes**“ mbi bazë të mosdurimit fetar. Krahas kësaj, nga aspekti i kontekstit në të cilin ato janë dhënë, gjatë matjes së interesave të kundërshtuara të lirisë së shprehjes dhe mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve për ta përcaktuar se a ka qenë e nevojshme përzierja për objektivat e nenit 10 (2), gjykatat turke është dashur më tepër peshë t'i japin faktit se **dorëzuesi i kërkesës ka qenë aktivisht i angazhuar në debat publik të drejtpërdrejtë**.

Për këtë shkak, Gjyqi pa dyshim pohoi se gjuha e lëndës ka propaguar, ka nxitur ose e ka arsyetuar urrejtjen mbi bazë të mosdurimit, dhe nuk e gëzon mbrojtjen e Gjyqit nga neni 10. Megjithatë, sipas mendimit të Gjyqit, vetëm mbrojtja e sheriatit, **pa bërë thirrje për përdorimin e dhunës për instalimin e tij, nuk mund të konsiderohet për „gjuhë e urrejtjes“**. Nga aspekti i kontekstit, Gjyqi përcaktoi se nuk është dëshmuar bindshëm se kufizimi ka qenë i nevojshëm. Për objektivat e nenit 10, **nuk ka pasur shkaqe të mjaftueshme** që të arsyetohet përzierja në të drejtën e lirisë së shprehjes së dorëzuesit të kërkesës. GJEDNJ konstatoi **shkelje të nenit 10** të Konventës.

Si përfundim për rastin: edhe pse ndalesa për gjuhën e urrejtjes **është e paraparë me ligj, dhe edhe pse Gjyqi u pajtua** me gjyqin turk se ndalesa e programit është në pajtim me ligjet turke, dhe konstatoi se gjyqet nacionale kanë pasur **objektiv legjitim** kur e kanë ndaluar programin – Gjyqi megjithatë kishte konstatuar se vetë ndalesa **nuk ka qenë e nevojshme në një shoqëri demokratike**.

6 Korniza rregullatore maqedonase për „gjuhën e urrejtjes“

Duhet të theksohet që korniza rregullatore maqedonase i ndjek udhëzimet e Konvetës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për të mundësuar rregullimin ligjor të „gjuhës së urrejtjes“ përmes kodeve administrative, civile dhe penale.

6.1 Ligji për shërbimet mediatike audio dhe audiovizive

Neni 4 i Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizive (më tej në tekst: „Ligji“) thekson që „trup kompetent për çështjet që janë lëndë e këtij Ligji është Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive “ (më tej në tekst: ASHMAAV).

Në nenin 48 të Ligjit, ndalesat e veçanta për „gjuhën e urrejtjes“ definoohen si në vazhdim:

*„Shërbimet mediatike audio dhe audiovizive **nuk guxojnë** të përmbajnë programe me të cilat:*

- *kërcënohet siguria nacionale,*
- *bëhet nxitja e rrënimit të dhunshëm të rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë,*
- *bëhet thirrje në agresion luftarak ose në konflikt të armatosur,*
- *bëhet nxitja ose përhapja e diskriminimit, e mosdurimit ose e urrejtjes mbi bazë të racës, gjinisë, religjionit ose nacionalitetit.*

Në nenin 48, paragrafi 2, është theksuar që:

Ndalesat e veçanta nga paragrafi (1) i këtij neni do të jenë në pajtim me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Kjo dispozitë e autorizon Agjencinë që ta shfrytëzojë të drejtën precedentale të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në çdo vendim që do të marrë, dhe në pajtim me këtë Shpjegues.

Më tej, në nenin 6 është përcaktuar që ASHMAAV ka kompetencë, mes tjerash, që **„të ndërmarrë masa në pajtim me këtë ligj në rastet kur është bërë shkelja e dispozitave të këtij ligji ose të dispozitave të nxjerra mbi bazë të tij dhe të kushteve dhe detyrimeve nga lejet“**. Kjo i jep autorizim të qartë ASHMAAV-it që të reagojë gjatë shkeljes së cilitdo nen tjetër të Ligjit, përfshi dhe nenin 48 dhe identifikimin e „gjuhës së urrejtjes“. Megjithatë, duket që ligdhënësit i ka shpëtuar që në mënyrë precize ta bëjë aktimin e masave specifike të cilat Agjencia mund t'i shfrytëzojë kundër dhënësve të shërbimeve audio dhe audiovizive në Maqedoni, për të cilën gjë ka një PJESË saktësisht të rregulluar “për ndërmarrjen e masave për të ndërprerë në kohë transmetimin dhe pranimin e shërbimeve mediatike audio dhe audiovizive nga vende të treta në territorin e Republikës së Maqedonisë në pajtim me nenin 45 të këtij Ligji“.

Në pajtim me nenin 7, „puna e Agjencisë më afërsisht rregullohet me Rregulloren e punës së Agjencisë“, që do të thotë se Agjencia mund ta zhvillojë procedurën **për nxjerrjen e akteve nënligjore dhe të akteve të tjera që dalin nga ky Ligj**, që, sërish, mund të jetë akt nënligjor për rregullimin shtesë të „gjuhës së urrejtjes“.

Nëse **Agjencia konstaton shkelje të dispozitave të këtij Ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra mbi bazë të tij**, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në leje dhe në aktet tjera të Agjencisë, drejtori mund të marrë masa kundër botuesit të medias, dhënësit të shërbimeve audio dhe audiovizive me kërkesë ose operatorëve të rrjeteve komunikuese elektronike që bëjnë riemtimin e serviseve programore, në pajtim me nenin 23.

Më tej aktohet që Agjencia:

- **do të nxjerrë vendim për vërejtje me shkrim;**
- **do të dorëzojë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse** në rastet kur, edhe krahas nxjerrjes së vendimit për vërejtje, e njëjta shkelje që është shkas për vërejtjen me shkrim vazhdon gjatë vitit;
- **do t'i dorëzojë propozim Këshillit që të merret leja, ose**
- **do të marrë vendim për fshirje nga Regjistri në pajtim me këtë Ligj.**

Problemi me të cilin Agjencia mund të ballafaqohet është emetimi i „gjuhës së urrejtjes“ serioze nga ana e mediave, kur vërejtja me shkrim nuk është e mjaftueshme dhe kur Agjencia duhet të ketë vegël më të fortë reagimi, si për shembull ajo e paraparë për riemtimin e programeve të huaja.

6.2 Kodi penal

Në lidhje me rregullimin e „gjuhës së urrejtjes“ nga aspekti penal – kjo në detaje është aktuar në Kodin penal. Ka disa vepra penale të cilat janë të lidhura me „gjuhën e urrejtjes“ dhe të njëjtat janë dhënë më poshtë në tekst.

E para është „rrezikimi i sigurisë“ (neni 144), ku është theksuar:

*Ai që do të rrezikojë sigurinë e tjetrit **me kërcënim serioz se do të sulmojë jetën ose trupin e tij ose jetën a trupin e personit të afërm me të**, do të dënohet me dënim me të holla ose me burg deri në gjashtë muaj.*

Ai që do ta kryejë veprën nga paragrafi 1 gjatë ushtrimit të dhunës në familje, do të dënohet me burg prej tre muaj deri në tre vjet.

Me dënimin nga paragrafi 2 do të dënohet ai që veprën nga paragrafi 1 do ta bëjë ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së shërbimit ose ndaj më shumë personave.

Ai që përmes sistemit informatik do të kërcënohet se do të kryejë veprë penale për të cilën është aktuar dënim me burg prej pesë vjetësh ose dënim më i rëndë, kundër ndonjë personi për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, klasës së tij, përkatësisë së tij ndaj grupit të marginalizuar, grupit etnik, gjuhës, nacionalitetit, prejardhjes sociale, bindjes fetare,

bindjeve të tjera, arsimit, përkatësisë politike, gjendjes personale ose sociale, pengesës mentale ose fizike, gjendjes familjare ose martesore, statusit pronësor, gjendjes shëndetësore ose cilëndo bazë tjetër të paraparë me ligj ose me marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuar, do të dënohet me dënim me burg prej një deri në pesë vjet.

Krahas kësaj, në nenin 319 përshkruhet vepra penale me të cilën **shkaktohet urrejtje, përçarje ose mosdurim mbi bazë diskriminuese nacionale, racore, fetare ose çfarëdo tjetër, në këtë mënyrë:**

Ai, që me shtrëngim, maltretim, rrezikim të sigurisë, shpallim përbuzës të simboleve nacionale, etnike, fetare e të tjera, me nderje, shkatërrim ose dëmtim në tjetër mënyrë të flamurit të Republikës së Maqedonisë ose të flamujve të shteteve të tjera, me dëmtim të gjësendeve të huaja, me përdhosjen e përmendoreve, të varreve apo në një mënyrë tjetër diskriminuese, direkt ose indirekt, do të shkaktojë ose do të nxisë urrejtje, përçarje apo mosdurim mbi bazë të gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, farës, përkatësisë së grupit të marginalizuar, përkatësisë etnike, gjuhës, shtetësisë, prejardhjes sociale, religjionit apo besimit fetar, llojeve të tjera të besimit, arsimit, përkatësisë politike, statusit personal apo shoqëror, pengesës mentale ose trupore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, statusit pronësor, gjendjes shëndetësore, apo mbi cilëndo bazë tjetër të paraparë me ligj ose me marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuar, do të dënohet me burg prej një deri në pesë vjet.

Ai që veprën nga paragrafi (1) i këtij neni e kryen duke keqpërdorur pozitën ose autorizimin ose nëse për shkak të atyre veprave ka ardhur deri në trazira dhe dhunë ndaj njerëzve ose deri në dëme me përmasa të mëdha, do të dënohet me burg prej një deri në dhjetë vjet.

Neni 394 (g) e përshkruan veprën penale **përhapje të materialit racist dhe ksenofobik përmes sistemeve kompjuterike, dhe e përshkruan si në vazhdim:**

Ai që përmes sistemeve kompjuterike në publik përhap material të shkruar racist dhe ksenofobik, figurë ose reprezentim tjetër të idesë ose teorisë që ndihmon, promovon ose nxit urrejtje, diskriminim ose dhunë, kundër cilitdo person ose grup, mbi bazë të gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, farës, përkatësisë ndaj grupit të marginalizuar, përkatësisë etnike, gjuhës, shtetësisë, prejardhjes sociale, religjionit ose besimit fetar, llojeve të tjera të besimit, arsimit, përkatësisë politike, statusit personal ose shoqëror, pengesës mentale ose trupore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, statusit pronësor, gjendjes shëndetësore, apo mbi cilëndo bazë tjetër të paraparë me ligj ose me marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuar, do të dënohet me burg prej një deri në pesë vjet.

Me dënimin e paragrafit (1) të këtij neni do të dënohet edhe ai që veprën do ta kryejë përmes mjeteve të tjera të informimit publik.

Ai që veprën e paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni e kryen duke keqpërdorur pozitën ose autorizimin ose nëse për shkak të atyre veprave ka ardhur deri në trazira dhe dhunë ndaj njerëzve ose deri në dëme pronësore me përmasa të mëdha, do të dënohet me burg prej një deri në dhjetë vjet.

Neni 407a e pengon miratimin ose arsyetimin e gjenocidit, të krimeve kundër njerëzimit ose të krimeve të luftës, duke e rregulluar të njëjtën në këtë mënyrë:

Ai që përmes sistemit informativ publikisht i mohon, ashpër i minimizon, i miraton dhe i arsyeton veprat nga neni 403 deri 407, do të dënohet me burg prej një deri në pesë vjet.

Nëse mohimi, minimizimi, miratimi apo arsyetimi është bërë me qëllim që të nxitet urrejtje, diskriminim ose dhunë kundër ndonjë personi ose grupi personash për shkak të përkatësisë së tyre nacionale, etnike ose racore, kryerësi do të dënohet me dënim me burg më së paku katër vjet.

Veprat që lidhen me **diskriminimin racor ose me ndonjë diskriminim tjetër** janë rregulluar me nenin 417:

Ai që mbi bazë të dallimit të gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, farës, përkatësisë së grupit të marginalizuar, përkatësisë etnike, gjuhës, shtetësisë, prejardhjes sociale, religjionit ose besimit fetar, llojeve të tjera të besimeve, arsimit, përkatësisë politike, statusit personal ose shoqëror, pengesës mentale ose trupore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, statusit pronësor, gjendjes shëndetësore, apo cilësdo bazë tjetër të paraparë me ligj ose me marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuar, i shkel të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të njohura nga ana e bashkësisë ndërkombëtare, do të dënohet me burg prej gjashtë muaj deri në pesë vjet.

Me dënimin nga paragrafi 1 do të dënohet edhe ai që bën persekutimin e organizatave ose individëve për shkak të angazhimit të tyre për barazi mes njerëzve.

Ai që përhap ide për superioritetin e një race ndaj tjetrës ose propagon urrejtje racore ose që nxit në diskriminim racor, do të dënohet me burg prej gjashtë muaj deri në tre vjet.

6.3 Ligji për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi

Dhe në fund, ekziston **Ligji për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi**, i cili në nenin 4 të vet thotë se „ky Ligj do të aplikohet nga ana e të gjitha organeve shtetërore, organet e njësisë të vetëqeverisjes lokale, **personat juridikë me autorizime juridike publike** dhe persona juridikë e fizikë nga sfera e...., **informimit publik dhe mediave**“. Sipas kësaj, ASHMAAV duhet të jetë përgjegjëse edhe për zbatimin e Ligjit për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, për të cilën gjë njëri prej rekomandimeve në fund të tekstit thotë se duhet pasur bashkëpunim të afërt ndërmjet ASHMAAV dhe rregullatorit relevant nga ky ligj në luftë kundër diskriminimit.

Në nenin 5, pika 3, definohet domethënia e **diskriminimit** si „çdo dallim i bërë, direkt ose indirekt, juridikisht ose faktikisht i pajustificuar, ose veprim i pabarabartë, përkatësisht shmangie (përgjashtim, kufizim ose dhënie e përparësisë) në lidhje me persona ose grupe, që mbështetet në gjini, racë, ngjyrën e lëkurës, farë, përkatësi ndaj grupit të marginalizuar, përkatësisë etnike, gjuhës, shtetësisë, prejardhjes sociale, religjionit ose besimit fetar, arsimit, përkatësisë politike, statusit personal ose shoqëror, pengesës mentale ose trupore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, statusit pronësor, gjendjes shëndetësore apo

cilësdo bazë tjetër“. Duhet të precizohet se a do të duhet që ASHMAAV ta shfrytëzojë këtë definicion në punën e saj të përditshme kur bën monitorimin e programit.

7 Udhëzime për monitorimin e „gjuhës së urrejtjes“

Gjatë konstatimit të gjuhës së urrejtjes, shumica e trupave rregullatorë në sferën audiovizive si parime të tyre prijëse i shfrytëzojnë shembujt nga e drejta precedentale e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të gjykatave vendore. Premisë bazë edhe e GJEDNJ edhe e gjykatave vendore është se të gjitha rastet e nxitjes duhet të shqyrtohen veç e veç.

Sfidë kryesore për rregullatorin audioviziv gjatë veprimit me ndalesat për gjuhën e urrejtjes në shërbimet mediatike audiovizive lineare dhe jolineare nën kompetencën e vet, është të përcaktojë se si do ta tërheqë vijën ndërmjet formave të gjuhës publike (ofenduese, e vrazhdë, nënçmuese etj.), të cilat do të duhet të tolerohen në një shoqëri demokratike dhe të gjuhës e cila patjetër duhet të ndalohej dhe të sanksionohet që të mbrohen të drejtat e individëve dhe grupeve në lidhje me diskriminimin apo gjuhën që mund të sjellë dhunë, trazirë publike ose kriminalitet.

GJEDNJ dhe gjykatat vendore vendimet e tyre gjithnjë i mbështesin mbi rrethana konkrete për secilin rast veç e veç. Kjo do të thotë se ka shumë faktorë vendosës të cilët patjetër duhet të merren parasysh kur tërëqihet „...vija ndarëse midis asaj që është e lejueshme dhe asaj që nuk është e lejueshme: kjo në të vërtetë është përmbledhje elementesh variabël, të cilat me patjetër duhet të kombinohen veçmas për çdo rast”.²²

Vështirësitë dhe dilemat që janë të lidhura me vlerësimin e një komunikimi publik të caktuar në formën e gjuhës e cila me patjetër duhet të ndalohej, dalin nga fakti se “gjuha e urrejtjes” jo përherë është e shprehur në formë eksplicite, por është e pranishme edhe në deklaratat të cilat grupe të ndryshme sociale ndryshe-ndryshe shikojnë. Dëshmitë nga hulumtimet tregojnë se ndonjëherë, bile, edhe porositë që përmbajnë forma implicite të stereotipizimit të grupeve kulturore të ndryshme etnike, religjioze ose të tjera mund të aktivizojnë dhunë dhe shqetësim.

Objektivi kryesor i Udhëzimeve të prezantuara më poshtë është që të sigurojnë për Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive pasqyrë të shkurtër të parimeve bazë ose të metodologjive që do të duhet të ndiqen gjatë detektimit dhe analizimit të porosive që përhapen përmes shërbimeve mediatike audiovizive lineare dhe jolienare në lidhje me ndalesën për nxitjen e urrejtjes të aktuar në Ligjin për shërbime mediatike audio dhe audiovizive. Dispozita që përmban Ligji është harmonizuar me nenin 6 të Direktivës për SHMAV dhe i siguron bazë juridike Agjencisë për pengimin e përhapjes së gjuhës së urrejtjes në shërbimet MAV. Këto dispozita, në të vërtetë, janë të implementuara në të drejtën precedentale të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të gjykatave vendore ose janë të

²² Shih fq. 24 të Doracakut në lidhje me gjuhën e urrejtjes të KiE. Arritja në:
http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/hrpolicy/publications/hate_speech_en.pdf

elaboruara në forma të ndryshme në udhëzime, doracakë dhe dokumente të tjera të ndryshme të publikuara nga ana e organizatave ndërkombëtare.²³

7.1 Cili ka qenë konteksti i shprehjes?

Pyetja e parë të cilën gjyqi e merr parasysh kur e vlerëson praninë e “gjuhës së urrejtjes” në rastin konkret është evaluimi gjithëpërfshirës i *kontekstit të shprehjes*²⁴. Çdo analizë e kontekstit duhet ta vë “porosinë” specifike në një kontekst më të gjerë shoqëror dhe politik në të cilin porosia është krijuar dhe diseminuar. Raportimet mediatike të cilat shpesh përmbajnë porosi që bëjnë thirrje në dhunë kundër individëve ose grupeve që u takojnë bashkësive të ndryshme do të kishin pasoja të ndryshme në kontekste të ndryshme. Ka vende me histori të gjatë tensionesh ndëretnike dhe ndërreligjioze ose me mjedise më konservatore dhe më autokrate. Nga ana tjetër, ka vende me histori politike relativisht më paqësore dhe me nivel më të lartë të tolerancës në lidhje me bashkësitë e ndryshme dhe me mendimet e kundërshtueshme në shoqëri.

Për këtë shkak, analizat e rrethanave historike, politike dhe shoqërore në vend duhet të japin përgjigje në këto pyetje në vazhdim:

- A ka histori konfliktesh në shoqëri? Cila është situata momentale në shtet? A ka ende konflikte ose tensione post-konfliktuale midis grupeve relevante? Cilat janë dukuritë e fundit të dhunës që kanë qenë rezultat nga shembuj të tjerë të nxitjes së urrejtjes? A ekzistojnë faktorë të tjerë rreziku në shoqëri që mund të sjellin dhunë kundër një grupi të caktuar?
- A janë të gjitha grupet në shoqëri të mbrojtura në mënyrë të barabartë në nivelin juridik dhe institucional? Si kanë reaguar institucionet relevante në rastet e diskriminimit dhe të nxitjes së sjelljes së dhunshme kundër individëve ose grupeve të caktuara? Cila është klima më e gjerë politike dhe cili është niveli i tolerancës ndaj grupeve dhe bashkësive të ndryshme në shoqëri?
- Cili është statusi i përgjithshëm socio-ekonomik i bashkësisë për të cilën flitet? Pjesëtarët e kësaj bashkësie a ballafaqohen me pasiguri ekonomike, me papunësi, me qasje të rënduar te resurset e kështu me radhë?

²³ Burimet kryesore që janë shfrytëzuar për të përgatitur Udhëzimet janë: e drejta precedente e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Artikulli 19, dokumenti “Prohibiting Incitement to Discrimination, Hostility or Violence” (dhjetor 2012), CoE Manual on Hate Speech (shtator 2009) dhe dokumente e artikuj të tjerë akademikë.

²⁴ Shih më shumë për këtë në: Oetheimer, M. (2009). Protecting Freedom of Expression: The Challenge of Hate Speech in the European Court of Human Rights Case Law. *Cardozo J. Int'l & Comp. L.*, 17, 427.

7.2 Kush është njeriu përgjegjës për shprehjen?

Niveli vijues i analizës ka të bëjë me identitetin dhe statusin e personit që është burim i shprehjes. Nga aspekti i përgjithshëm, individi me status shoqëror dhe me pozitë më të lartë zyrtare në shoqëri mund të ketë më shumë ndikim ndaj opinionit publik. Në këtë fazë duhet përgjigjur në disa pyetje:

- Personi që ka mbajtur fjalim publik/që ka dhënë deklaratë a është në pozitë të ndikojë ndaj mendimit publik? Ai/ajo a kanë autoritet që të ndikojnë ndaj pjesëve të rëndësishme të publikut?
- A është personi nëpunës publik dhe deklarata a është dhënë në cilësinë zyrtare të personit? Ai/ajo a është politikan ose anëtar i dalluar i partisë politike, duke marrë parasysh se nëpunësit publikë dhe politikanët e kanë patjetër që të përmbahen nga dhënia e deklaratave provokative dhe jotolerante?
- Njeriu a është person publik me status të veçantë në shoqëri (lider fetar ose karizmatik) që i mundëson që të ketë ndikim më të fortë ndaj publikut? Si e sheh publiku këtë njeri? A tregon respekt të tepruar ndaj autoritetit, për të cilën gjë i nënshtrohet nxitjes?

7.3 A ka ekzistuar qëllimi për provokimin e gjuhës së urrejtjes?

Komponent i rëndësishëm vijues i vlerësimit është ekzistimi i qëllimit nga ana e folësit. Artikulli 19 e definon qëllimin si “Vullnet (volition) (këmbëngulje me qëllim) për t’u mbështetur urrejtja, ...drejtuar ndaj grupit të mbrojtur mbi bazë të pikëmbështetjeve të palejueshme, duke qenë me këtë rast i vetëdijshëm për pasojat nga veprimet e veta dhe duke e ditur që pasojat do të ndodhin ose mund të ndodhin gjatë rrjedhës së zakonshme të ngjarjeve.”²⁵

Prania e qëllimit është vështirë të dëshmohet, përveç nëse personi në mënyrë eksplicite nuk i pranon qëllimet e veta. GJEDNJ dhe gjykatat tjera vendosin për qëllimin mbi bazë të vlerësimit të rastit dhe rrethanave të tij si tërësi. Aspektet tjera me rëndësi, të cilat GJEDNJ i shqyrton, i përfshijnë pyetjet në vazhdim:

- Cila gjuhë specifike (fjalë ose shprehje) është shfrytëzuar nga ana e folësit? Sa ka qenë eksplicite gjuha? Çfarë toni ka pasur gjuha dhe cilat kanë qenë rrethanat e transmetimit të tij (të tonit-shën.)?
- Duke marrë parasysh kontekstin, qëllimi i folësit a ka qenë i paekuvok dhe i qartë për publikun? Folësi a ka pasur diçka tjetër në mend, e jo të nxisë urrejtje? Folësi a ka pasur për qëllim që ta informojë publikun për ndonjë çështje të caktuar me interes publik (raportim gazetaresk objektiv, film historik ose dokumentar)?

²⁵ Më shumë detaje shih në: “Prohibiting Incitement to Discrimination, Hostility or Violence,” Article 19, dhjetor 2012. Arritja në: <http://www.article19.org/data/files/medialibrary/3548/ARTICLE-19-policy-on-prohibition-to-incitement.pdf>

- Cilat shkallë dhe sa ka qenë numri i përsëritjeve të porosisë? Folësi a e ka përsëritur gjuhën diskriminuese më shumë herë dhe në disa raste?
- Folësi a ka mundur ta parashikojë ndikimin e mundshëm të gjuhës së vet? Folësi a e ka pasur për objektiv grupin konkret minoritar/fetar? Qëllimi i folësit a ka qenë i paekuivok dhe i qartë për publikun?

7.4 Cila është përmbajtja e shprehjes?

Përmbajtja e shprehjes së caktuar është aspekti vijues që duhet të analizohet. Ka të bëjë me: atë çka është thënë, formën dhe stilin e gjuhës, praninë e thirrjeve eksplicite në dhunë ose diskriminim e kështu me radhë. Ky nivel i analizës i përfshin pyetjet në vazhdim:

- Çka ka thënë individi? Fjalja a përfshin nxitje direkte të publikut që të veprojë në një drejtim të caktuar? Porosia a bën thirrje pa ekuivoke në dhunë, në armiqësi ose diskriminim, apo ka mundur të interpretohet në tjetër mënyrë?
- Cili është qëllimi-cilat janë grupet që synon gjuha t'i nxisë? Porosia a përmban referenca gjuhësore specifike, të cilat janë të rëndomta për grupet që nxiten?
- Cili është qëllimi-cilat janë viktimat potenciale të diskriminimit, të dhunës ose armiqësisë? Gjuha e përdorur a përmban referenca negative specifike për grupin "Tjetër" (të viktimave)? Grupi a është theksuar në mënyrë direkte apo indirekte?
- Si është thënë-cili ka qenë toni? Deri në çfarë shkalle gjuha ka qenë provokative dhe direkte? A ka përfshirë referenca lehtësuese? Shprehja a ka përmbajtur referenca emotive që mund të stimulojnë reagime të paligjshme të publikut?
- Cila ka qenë forma e shprehjes, duke marrë parasysh se forma të caktuara të shprehjes i nënshtrohen mbrojtjes më të madhe sipas nenit 10 (shprehje artistike, gjuhë politike, gjuhë fetare, hulumtim akademik)? Gazetari a ka dashur ta paraqesë "gjuhën e urrejtjes" si fenomen?

7.5 Cilat kanë qenë shkalla dhe shtrirja e shprehjes?

Çështja me rëndësi që duhet të shqyrtohet në vazhdim është në lidhje me natyrën publike të shprehjes, mjetet e diseminacionit të saj dhe shtrirja që ajo ka pasur. Ky nivel vlerësimi i përfshin pyetjet në vazhdim:

- Gjuha a i është kushtuar një numri të caktuar individësh apo pjesëtarëve të publikut të përgjithshëm?
- A është shprehur përmes medias elektronike? A është thënë në program të drejtpërdrejtë? Kur porosia diseminohet përmes medias audiovizive, ndikimi është direkt dhe më i fortë.
- Cila është shpeshtia, sasia dhe shkalla e komunikimit? Porosia a është emetuar një herë apo është përsëritur në disa raste?

7.6 Sa ka qenë probabiliteti për të ndikuar ndaj publikut dhe veprimeve të tij të ardhshme?

Pika e fundit e analizës është vlerësimi i mbasemës (probabilitetit) së dëmit që mund të ndodhë si pasojë e shprehjes. Me fjalë të tjera, duhet të parashihet se si do ta pranojë publiku porosinë dhe cilat veprime mund të vijnë si pasojë negative. Kriteret për vlerësimin e rrezikut nga aktivitetet negative duhet të përcaktohen për secilin rast veç e veç, kështu që do të jepet përgjigje në disa pyetje²⁶:

- Gjuha a është kuptuar nga publiku si thirrje për vepra diskriminuese, të dhunshme ose armiqësore?
- Folësi a ka mundur të ndikojë tek publiku?
- Publiku a ka pasur mjete për ta kryer aktivitetin që mbështetet, dhe të bëjë akte diskriminimi, dhune apo armiqësie?
- Grupi i targetuar a ka pësuar, ose a ka qenë objekt diskriminimi, dhune apo armiqësie kohëve të fundit?

Formati për raportim për rezultatet e monitorimit duhet ta ndjekë mënyrën se si Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut e vlerëson se a ka apo nuk ka nevojë për kufizimin e lirisë së shprehjes në çdo rast të veçantë. Kjo do të thotë që njësitë relevante duhet të përgatisin propozim ku do të theksohet se ka “gjuhë të urrejtjes” në media, duke cituar jo vetëm Ligjin për shërbime mediatike audio dhe audiovizive, por duke dhënë edhe shpjegime për objektivin legjitim për një vendim të tillë dhe përse është i nevojshëm kufizimi i tillë i lirisë së shprehjes në një shoqëri demokratike.

²⁶ Këto janë kriteret e propozuara në Artikullin 19 drejtuar dokumentit: “Prohibiting Incitement to Discrimination, Hostility or Violence” (Ndalim për nxitjen e diskriminimit, të armiqësisë ose të dhunës, dhjetor 2012).

8 Shqyrtimi i praktikave të trupave të tjerë rregullatorë gjatë monitorimit të „gjuhës së urrejtjes“

Shtrirja dhe regjimi i pushteteve rregullatore në sferën audiovizive, si drejtori civile, kur bëhet fjalë për raste me gjuhë të urrejtjes, ishte temë e Takimit të 39-të të EPRA – Platformës Evropiane për Pushtetet Rregullatore (EPRA - European Platform of Regulatory Authorities), që u mbajt në Budva në qershor të vitit 2014. Rezymeja e përfundimeve e paraqitur më poshtë është rezultat i analizës së paraqitur gjatë sesionit të dytë plenar në Budva²⁷.

Dëshmitë që jepen në analizën e EPRA-s tregojnë se çështjet në lidhje me gjuhën e urrejtjes janë temë me rëndësi të veçantë për rregullatorët audioviziv në Evropë, sidomos nëse merret parasysh dukuria e paraqitjes së një numri të madh të TV-shërbimeve të reja jolineare të cilat distribuohen përmes platformave të reja teknologjike. Gjithashtu, theksohet se çështja e gjuhës së urrejtjes duhet të shqyrtohet me shumë kujdes dhe në detaje nga ana e rregullatorëve audioviziv që të klasifikohet si e tillë.

- Në më shumë vende, gjuha e urrejtjes i nënshtrohet rregullativës ligjore për media dhe ligjeve penale. Ligjet nacionale për radiodifuzion, rëndom, përmbajnë dispozitë eksplicite me të cilën ndalohet “nxitja e urrejtjes”, mirëpo rrallë sigurohet definicioni detal i konceptit. Me dispozitat në ligjet për veprimtari radiodifuzive, gjithashtu, sigurohen informacione për bazat e ndryshme mbi të cilat ndalohet nxitja e urrejtjes: raca, gjinia, religjioni dhe nacionaliteti, përkatësia nacionale ose sociale, bindja, prejardhja etnike, ngjyra e lëkurës, gjuha, vlerat morale, identiteti/shprehja/orientimi/preferencat seksuale, arsimi, hendikepi etj.
- Dispozitat në rregullativën ligjore për media vlejnë edhe për shërbimet mediatike lineare dhe jolineare, në përjashtim të Mbretërisë së Bashkuar, ku shërbimet jolineare i nënshtrohen vetërregullacionit. Ofkom (Ofcom – trup rregullator i pavarur britanik për telekomunikacion dhe radiodifuzion) ka autorizim që të reagojë kundër TV-shërbimeve jolienare vetëm në rastet ekstreme me gjuhë të urrejtjes.
- Shmangiet juridike nga ndalimi i përgjithshëm i gjuhës së urrejtjes ekzistojnë vetëm në rastet me përmbajtje radiodifuzive që është pjesë e filmave dokumentarë shkencorë dhe të metrazhit të gjatë ose është pjesë e hulumtimit gazetaresk ku gjuha e urrejtjes analizohet si fenomen negativ nga perspektiva kritike.
- Gjatë konstatimit të gjuhës së urrejtjes, shumica e trupave rregullatorë si parim prijës e shfrytëzojnë të drejtën precedente të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të gjykatave vendore. Disa rregullatorë kanë nxjerrë udhëzime të veta të integruara në kodet për standardet programore (Ofkom, Gjibraltari). Në disa vende, rregullatorët bashkëpunojnë me trupa të veçantë të cilët e bëjnë përcaktimin një përmbajtje e caktuar, e publikuar në mediat audiovizive, a nxit

²⁷ EPRA, Projekt-dokument informativ: Rezyme e përgjigjeve nga Pyetësi për gjuhën e urrejtjes, paraqitur në Sesionin e 2-të plenar: *Gjuha e urrejtjes - armik i vjetër, beteja të reja*, Takimi i 39-të i EPRA-s, Budva, 4-6 qershor 2014.

urrejtje mbi baza të ndryshme (Inspektori i Etikës Gazetareske në Poloni dhe Lituani, Qendra Inter-Federale e Mundësive të Barabarta në Belgjikë).

- Në dy vitet e fundit, një numër i rëndësishëm rregullatorësh²⁸ ka procesuar raste të ndryshme të gjuhës së urrejtjes: dominim gjinor, çështje religjioze-fundamentaliste, gjuhë antisemitistike dhe ksenofobike, gjuhë ofenduese kundër imigrantëve, gjuhë e drejtuar kundër popullatës LGBT, romëve etj.
- Ka sanksione të ndryshme që u qëndrojnë në dispozicion rregullatorëve audioviziv: paralajmërim, urdhër për publikimin e gjetjeve të rregullatorit, urdhër për publikimin e korigjimit, dënime financiare, dhe në rastet shumë serioze, vendim për shkurtimin apo heqjen e lejes.
- Pason pasqyra më e detajuar për kornizën legjislativë dhe praktikën e pesë rregullatorëve. Krahas kësaj, janë zgjedhur raste relevante që të paraqitet se si ka vepruar çdo rregullator në lidhje me konstatimin e gjuhës së urrejtjes dhe llojet e sanksioneve që janë imponuar.

1. Mbretëria e Bashkuar

1.1. Korniza kushtetuese dhe juridike

Të tri vendet që janë pjesë e ishullit kryesor të Britanisë së Madhe kanë sisteme të ndryshme juridike. Anglia dhe Uells ndajnë të njëjtin sistem juridik, ndërkaq rregullativa ligjore e Skocisë është krejtësisht e ndryshme dhe me të udhëheq legjislativën e veçantë.²⁹

Mbretëria e Bashkuar (MB) nuk ka kushtetutë të kodifikuar, por një numër i madh aspektesh nga Ligji kushtetues mund të gjenden në të drejtën e MB, në veprat e analistëve udhëheqës dhe në praktikën e pjesëve të ndryshme të qeverisë.

E drejta penale e Mbretërisë së Bashkuar përmban disa ligje që rregullojnë kundërvajtje raciste: *Ligji për mbrojtjen nga shqetësimi* i vitit 1997, me të cilin instalohet kundërvajtja për shqetësim; *Ligji për rendin publik* i vitit 1986, i cili, gjithashtu, përfshin kundërvajtje për shqetësim mbi bazë të sjelljes ofenduese, të pahijshme ose kërcënuese; *Ligji për kriminalitet dhe parregullsi* i vitit 1998, i cili përmban dispozita me forma me motivim racor të shqetësimit.

Sipas pjesës 22 të Ligjit për rend publik, gjatë çfarëdo emetimi të ndonjë shërbimi të televizionit kabllor ose të radios, është kundërvajtje kyçja e programit që përmban pamje vizive ose zëra që janë

²⁸ Në analizën e EPRA-s është theksuar se 19 rregullatorë kanë paraqitur ekzistimin e rasteve të ndryshme të gjuhës së urrejtjes.

²⁹ Sistemi juridik në Irlandën Veriore nuk i nënshtrohet kësaj pasqyre. Edhe pse drejtohet nga përfaqësues të pushtetit qendror nën mbikëqyrje të pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ në Londër, ai ekziston i ndarë nga Britania e Madhe.

kërcënues, të pahijshëm ose ofendues, nëse janë me paramendim, ose mbase janë për të shkaktuar urrejtje racore. Kjo kundërvajtje mund të kryhet, njëkohësisht ose veçmas, nga ana e radiopërhapësit ose distributorit kabllor, nga ana e disa ose e të gjithë producentëve dhe regjisorëve të programit dhe realizuesve që janë të përfshirë në përmbartimin e kundërvajtjes. Pjesa 22 siguron mbrojtje të specializuara për secilën prej këtyre kategorive të mundshme të personave të akuzuar. Radiopërhapësit dhe distributorët kabllorë do t'i ikin përgjegjësisë vetëm nëse dëshmojnë se për ta nuk ka qenë i mundur realizimi i arsyeshëm i heqjes së materialit ofendues nga programi.

Në të drejtën civile dhe administrative të Mbretërisë së Bashkuar ka disa akte të cilat vënë norma në lidhje me diskriminimin: Norma për barazi në punësim (religjion ose bindje) e vitit 2003, Norma për barazi në punësim (orientim seksual) e vitit 2003, Norma për Ligjin kundër diskriminimit të personave me hendikep 1995 (ndryshime) e vitit 2003, Ligji për raportet e racave i vitit 1976 dhe *Ligji për të drejtat e njeriut* i vitit 1998.

Ligji për të drejtat e njeriut e inkorporon Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në të drejtën e Mbretërisë së Bashkuar. Ai ka aktuar që e tërë rregullativa ligjore (e kaluar dhe e ardhshme) duhet të lexohet dhe të aplikohet sa më shumë që të jetë e mundur në mënyrën që është kompatible me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Spektori radiodifuziv i MB i nënshtrohet rregullimit më të detajuar, ndërsa shtypi dhe mediat on-line janë të vetërregulluara. Dokumenti kryesor legjislativ për radiodifuzion është *Ligji i komunikimeve* i vitit 2003, me të cilin rregullohen edhe përmbajtjet radiodifuzive edhe telekomunikimet. Krahas *Ligjit të komunikimeve*, ende janë relevante dispozitat nga *Ligjet për radiodifuzion* 1990 dhe 1996. Tre trupat rregullatorë, të cilët më parë kishin punuar në çështjet që lidhen me përmbajtjen e transmetuar – Komisioni i Pavarur Televiziv (ITC), Trupi Përgjegjës për Radio (RA) dhe Komisioni për Standarde Radiodifuzive (BSC) janë lidhur (bashkë me agjencinë për spektrin RCA dhe rregullatorin e telekomit Oftel) në një trup: Ofkom (Ofcom). Rrjedhimisht, rregullimin ligjor në sektorin radiodifuziv në MB e kryen Ofkom, që paraqet trupin rregullator të bashkuar për telekomunikime dhe radiodifuzion. Me *Ligjin e komunikimeve* qartë është aktuar që Ofkom nuk ka kompetenca në lidhje me përmbajtjen në Internet nga aspekti i përgjithshëm.

1.2. Autorizime dhe praktika të Ofkom-it në lidhje me gjuhën e urrejtjes

Ofkom i rregullon shërbimet e pavarura televizive në pajtim me kushtet nga Ligji i komunikimeve dhe nga Ligji për radiodifuzion i viteve 1990 dhe 1996. Në pjesën 319 nga Ligji i komunikimeve nga Ofkom kërkohet që të krijohet Kode për standarde, si dhe të bëjë pasqyrën, por dhe revidimin, e atyre standardeve për përmbajtjen e programeve që duhet të përfshihen në shërbimet televizive dhe të radios. Në pjesën tre të Kodit radiodifuziv³⁰ instalohen standarde në lidhje me veprat penale. Rregulla 3.1 thotë se: „Materiali që

³⁰ Mund të shihet në: <http://stakeholders.ofcom.org.uk/broadcasting/broadcast-codes/broadcast-code/>, Hapur më 10 shtator 2014.

do të mund të nxiste ose të provokonte kryerjen e veprës penale ose që do të çonte drejt trazirave nuk guxon të përfshihet në shërbimet televizive ose të radios “.

Krahas autorizimit për të krijuar kode standardesh, Ofkom gjithashtu krijon Udhëzime të cilat kanë për qëllim që t'u ndihmojnë radiopërhapësve në interpretimin dhe aplikimin e Kodit radiodifuziv. Në Udhëzimet për pjesën 3 – Vepër penale³¹, jepet një shpjegim më i detajuar në lidhje me Rregullën 3.1: „vepra penale’ ka të bëjë me shkeljet të cilat sipas Kodit penal dënohen me dënim me të holla ose me dënim me burg. ‘Trazira’ mund t'i referohet veprës penale trazirë qytetare ose mund të jetë më e përgjithshme dhe të përfshijë vepra të cilat mund të çojnë drejt, apo mund të provokojnë, kryerjes së veprës penale.”

Ofkom ka miratuar veprime të detajuara për hulumtimin e shkeljeve të standardeve për përmbajtje për televizionin dhe radion³². Ofkom mund të nisë hetime me iniciativën e vet, si dhe të hetojë ankesat. Procedurat për hetimet e bëra sipas ankesës dhe hetimit të iniciuar nga Ofkom janë të njëjta. Në rastin e parë, Ofkom së pari do të shikojë se ankesa a ngre çështje potencialisht të rëndësishme sipas Kodit, me udhëzimin për seriozitetin dhe/apo shtrirjen e çështjes për të cilën ka ankesë. Nëse Ofkom konsideron se çështja duhet të vlerësohet më tej, mund të kërkojë nga radiopërhapësi që të dorëzojë kopje nga programi relevant, e cila patjetër duhet të sigurohet në afat prej pesë ditëve të punës. Mbi bazë të vlerësimit të parë të ankesës dhe shikimit të përmbajtjes relevante, Ofkom do të shikojë se a ka pasur shkelje të dispozitave të caktuara të Kodit. Nëse nuk ka, Ofkom do të vendosë që mos të vazhdojë më tej me hetimin dhe do ta publikojë vendimin në Buletinin e vet radiodifuziv. Vlerësimi i parë duhet të mbarojë në afat prej 15 ditësh.

Në rastin e hetimit të hapur, Ofkom do t'i rezymojë pjesët materiale nga ankesa/rasti, do t'i përcaktojë dispozitat relevante nga Kodi dhe do t'i bëjë thirrje radiopërhapësit që të japë përgjigjen e vet dhe të dorëzojë ankesë (dhe t'i sigurojë të gjitha dëshmitë relevante si mbështetje) në afat prej 10 ditëve të punës. Gjithashtu, në ueb-faqen e vet do t'i publikojë detajet për programet që janë nën hetim. Ofkom këmbëngul t'i mbyll rastet që janë nën hetim në periudhë prej 50 ditëve të punës.

Pas pranimit të ankesës nga radiopërhapësi, Ofkom do ta përgatit mendimin e vet preliminar, që është vetëm projekt-mendim dhe mund t'i nënshtrohet ndryshimit nga aspekti i parashtrimeve të njëpasnjëshme nga ana e radiopërhapësit. Mendimi i këtillë preliminar përmban:

- rezymenë e rastit;
- rezymenë e pjesëve të programit me të cilat rasti ka të bëjë;
- dispozitat relevante të Kodit radiodifuziv që vlejnjë për rastin;
- vlerësimin preliminar të Ofkom-it për shkeljen e dispozitave të tilla dhe arsyetimin për këtë vlerësim.

³¹ Mund të shihet në: <http://stakeholders.ofcom.org.uk/binaries/broadcast/guidance/831193/section3.pdf>, hapur më 10 shtator 2014.

³² Mund të shihet në: <http://stakeholders.ofcom.org.uk/broadcasting/guidance/complaints-sanctions/standards/>, hapur më 10 shtator 2014.

Nga radiopërhapësi kërkohet që të dorëzojë përgjigje zyrtare në lidhje me mendimin preliminar në afat prej 10 ditëve të punës. Ofkom do ta marrë vendimin e vet definitiv me atë që do ta marrë parasysh arsyetimin për rastin nga ana e radiopërhapësit. Radiopërhapësit e marrin kopjen e vendimit (vetëm për korrigjimin e fakteve), para se ai të jetë botuar në Buletinin radiodifuziv dhe në ueb-faqe.

Përgjithësisht, Ofkom ka autorizimin që të shqiptojë sanksione ligjore nëse shkeljet e Kodit radiodifuziv ose kushtet nga leja janë: serioze, me qëllim, përsëriten dhe janë të pamatura. Ka disa dënime të mundshme që mund të imponohen: urdhër që mos të përsëritet programi; urdhër për publikimin e korrigjimit/komunikatës me gjetjet e Ofkom-it; shkurtim ose suspendim i lejës (vlen vetëm për lloje të caktuara të lejës); dënim me të holla dhe heqje e lejës. Në pajtim me pjesën 239 nga Ligji i komunikimeve i vitit 2003, për raste veçanërisht serioze të gjuhës së urrejtjes Ofkom ka autorizimin që menjëherë ta suspendojë lejen. Ka disa raste në të cilat Ofkom ka intervenuar:

- Radio Ethe Aziatike (Radio Asian Fever) në nëntor të vitit 2011 – kundër radiostacionit të vogël lokal në Anglinë Veriore, për emetimin e gjuhës e cila do të mund të nxiste sjellje të dhunshme kundër homoseksualëve;
- DM Dixhital (DM Digital) në korrik të vitit 2013 – kundër TV kanalit të kthyer kah publiku aziatik në MB, për deklaratën e një dijetari islam që ka thënë se „të gjithë myslimanët janë të obliguar që t'i vrasin ose t'i sulmojnë ata që do ta ofendojnë Profetin”. (dënimi £85,000);
- Sangat TV në gusht të vitit 2013 – kundër TV Kanalit të drejtuar kah bashkësia e sikëve në MB, për thirrje indirekte për ndërmarrjen e veprimeve të dhunshme kundër një gjenerali të pensionuar të armatës indiane, në një diskutim në lidhje me një sulm të dhunshëm në Londër (dënimi në shumë prej £30,000);
- Nur TV (Noor TV) në shtator të vitit 2013 – kundër TV-kanalit që emeton programe për Islamin në gjuhë të ndryshme, për deklaratën e një dijetari islam që ka theksuar se „është e pranueshme, bile dhe obligim i myslimanëve që ta vrasin gjithsecilin për të cilin konsiderojnë se ka treguar mosrespekt ndaj Profetit“ (dënimi në shumë prej £85,000).

2. Franca

2.1. Korniza kushtetuese dhe juridike

Franca e garanton barazinë e të gjithë qytetarëve para ligjit, pa bërë dallim mbi bazë të prejardhjes, racës ose religjionit. Të drejtat dhe liritë themelore në Francë janë të garantuara në preambulën e Kushtetutës së vitit 1958, që të çon kah preambula e Kushtetutës së vitit 1946, e cila mbështetet në Deklaratën për të Drejtat e Njeriut të vitit 1789. Në nenin 2 të Kushtetutës së vitit 1958 thuhet që Franca „...do të sigurojë barazinë e të gjithë qytetarëve para ligjit, pa bërë dallim mbi bazë të prejardhjes, racës ose religjionit. Të gjitha bindjet do të respektohen.“

Franca ka miratuar disa ligje antiraciste. Me Ligjin e datës 1 korrik 1972 u formua baza e këtij Kodi. Këtë ligj e përmban edhe Kodi penal (pengimi i veprave të diskriminimit: neni 416), edhe Ligji i datës 29 korrik 1881 për lirinë e shtypit. U është shtuar ligjeve të miratuara më 1975, 1977, 1983, 1985 dhe 1987. Përfundimisht, me Ligjin e ri për shtyp të datës 13 korrik 1990 (pjesa 24a) është kompletuar përmbledhja e ligjeve, me krijimin e kundërvajtjes për kontestimin e krimeve kundër njerëzimit.

Kodi penal i ri, që hyri në fuqi më 1 mars 1994, ndryshon, shton, bile dhe krijon një numër të caktuar dispozitash për racizmin. Në tërësi, janë futur dënime më të ashpra për kundërvajtje raciste. Në nenin 225-1 të Kodit të ri penal francez është dhënë definicioni për diskriminimin si „çdo dallim që bëhet mbi bazë të prejardhjes ose të përkatësisë (apo të mos-përkatësisë) një grupi etnik, kombi, race ose religjioni“. Në këtë nen është përfshirë edhe dënimi për diskriminim kundër personave fizikë për të njëjtat shkaqe. Me dispozitat tjera të Kodit penal ndalohen edhe kundërvajtjet e llojeve të tjera: gjenocidi, krimet tjera kundër njerëzimit, racizmi, nxitja jo-publike e diskriminimit, urrejtja ose dhuna racore etj.

Me Kodin e ri penal nuk ndryshojnë kundërvajtjet e definuara në Ligjin e datës 29 korrik 1881 për lirinë e shtypit, i cili mbetet në fuqi. Ligji i vitit 1881 përmban masa sipas të cilave kundërvajtje është të mbrohen ose të kontestohen krimet ndaj njerëzimit, të nxitet diskriminimi, urrejtja o dhuna ose të bëhet shpifje apo ofendim ndaj racës, grupit etnik, kombit ose religjionit. Njerëzit që shkruajnë grafite dhe mbishkrime raciste në ndërtesa publike ose private i nënshtrohen ndjekjes penale jo vetëm për dëmtim me qëllim apo përdhosje të varreve, por edhe për kundërvajtje raciste, kur do të dëshmohen. Për të pasur ekzistimin e njëres prej kundërvajtjeve të theksuara më lart, veprat patjetër të jenë të nxjerra para publikut përmes njërit prej mjeteve për publikim: mjeteve të shtypura, vizatimeve, veprave të gdhendura, pikturave artistike, emblemave, fotografive ose çfarëdo mediumi tjetër të shkruar, verbal ose viziv, që shitet ose distribuohet, vihet në shitje ose ekspozohet para publikut, si dhe çfarëdo mjetesh audiovizive për komunikim. Me Ligjin e vitit 1881 dënohet jo vetëm kryerësi, por edhe personat që i kanë kontribuar manifestimit të kundërvajtjes, madje edhe kur ata nuk kanë marrë pjesë direkte në kryerjen e saj. Sipas pjesës 42, dënimit i nënshtrohen personat në vazhdim: botuesit ose redaktorët, shtypshkronjat, distributorët, shitësit etj. Sa u takon komunikimeve audiovizive, me Ligjin e datës 13 dhjetor 1985, që e

plotëson Ligjin e datës 29 korrik 1982, në të njëjtën mënyrë sistemohet përgjegjësia penale për këtë lloj kryerësish të kundërvajtjeve (pjesa 93-3).

Ligji për lirinë e komunikimeve (Loi relative à la liberté de communication) i shtatorit të vitit 1986 i përmban parimet më të rëndësishme me të cilat rregullohet përmbajtja që e ofrojnë serviset publike dhe radiopërhapësit komercialë. I njëjti ishte ndryshuar me Ligjin e datës 5 mars 2009 për komunikimet audiovizive dhe servisin e ri publik, i cili, gjithashtu, përfshiu edhe rregullimin e përmbajtjeve të cilën e ofrojnë shërbimet audiovizive „me kërkesë“ („on-demand“). Në pajtim me pjesën 2(3) të Ligjit, shërbimet televizive dhe shërbimet audiovizive me kërkesë bien në kuadrin që përfshin termi „komunikim audioviziv“. Me pjesën 1(2), pjesët 3-1(1) dhe (5) dhe me pjesën 15 të Ligjit, përcaktohet që trupi rregullator CSA do të sigurojë lirinë e komunikimeve, mirëpo kjo mund t'u nënshtrohet kufizimeve mbi bazë të nxitjes së urrejtjes³³. CSA mund të nxjerrë rekomandime për dhënësit e shërbimeve mediatike audiovizive, të cilat publikohen në Gazetën zyrtare.

2.2. Autorizime dhe praktika të CSA-së në lidhje me gjuhën e urrejtjes

Conseil supérieur de l'audiovisuel - CSA (Këshilli i Lartë Audioviziv, më tej në tekst: CSA) është formuar sipas Ligjit të datës 17 janar 1989, me autorizime që të garantojë lirinë në sferën radiodifuzive në Francë. I njëjti ka trashëguar *Haute Autorité de la communication audiovisuelle* (Pushtetin e Lartë të Komunikimeve Audiovizive, 1982-1986) dhe *Commission nationale de la communication et des libertés* (Komisionin Nacional të Komunikimeve dhe Lirive, 1986-1989). Përgjegjësitë e CSA janë me shtrirje të gjerë: sigurimi i pluralizmit të mendimeve të shprehura në sektorin audioviziv, monitorimi i mbulimit të fushatave zgjedhore, ndarja e frekuencave operatorëve, mbrojtja e të miturve, mbrojtja e dinjitetit njerëzor, mbrojtja e konsumatorëve e kështu me radhë. Gjithashtu, Këshilli është përgjegjës për ruajtjen e gjuhës dhe të kulturës franceze. Tash shpejt CSA ka marrë obligime të reja: programet televizive t'i bëjë me qasje për personat me dëgjim ose shikim të dëmtuar, të kujdeset që mediat ta marrin parasysh diversitetin e shoqërisë franceze, t'i mbështesë politikën për mbrojtje shëndetësore publike e kështu me radhë.

Njëri prej misioneve kryesore të CSA-së është të kujdeset që përmbajtja audiovizive e radiopërhapësve dhe e shërbimeve audiovizive jolineare t'i respektojë parimet bazë që i përmban Ligji i datës 30 shtator 1986 për lirinë e komunikimit. Këto parime përfshijnë respektimin e dinjitetit të njeriut, luftën kundër diskriminimit, ruajtjen e rendit publik dhe të ndershmërisë gjatë informimit. Derisa me nenin 1 të Ligjit të datës 30 shtator 1986 për lirinë e komunikimeve CSA fiton përgjithësisht autorizim që të

³³ Neni 15 akton që: "... programet të cilat mund t'i marrë publiku përmes shërbimeve komunikuese audiovizive nuk guxojnë të përmbajnë kurrnjëfarë lloji të nxitjes së urrejtjes ose të dhunës mbi bazë të racës, gjinisë, bindjes, religjionit ose nacionalitetit". Mund të shihet në:

<http://legifrance.gouv.fr/affichTexte.do?cidTexte=JORFTEXT000000512205&fastPos=1&fastReqId=78965485&categorieLien=cid&oldAction=rechTexte>

sigurohet respektimi i këtyre parimeve, ligjet tjera CSA-së i mundësojnë që të ndërmarrë aktivitete të ndryshme. Për shembull, me Ligjin e datës 29 korrik 1881 për lirinë e shtypit dënohen shpifja verbale dhe përqeshja, ndërsa me nenin 9 të Kodit civil rregullohet respektimi i privatësisë. Këto ligje u sigurojnë legjitimitet dhe bazë aktiviteve të CSA-së.

Kjo bazë juridike veçmas reflektohet tek obligimet të cilat CSA i vë në kontratat e nënshkuara nga ana e dhënësve të shërbimeve mediatike audiovizive. Këto marrëveshje kanë dispozita të qarta për dimensionet etike dhe respektimin e të drejtave të njeriut në programet që i ofrojnë shërbimet mediatike audiovizive. Për këtë shkak, kontratat përmbajnë obligime: të shmangët paraqitja e vuajtjes njerëzore, të respektohen ndjenjat e ndryshme politike, kulturore dhe religjioze të publikut, të promovohen vlerat e integritit dhe të solidaritetit, të kontrollohen informacionet dhe të paraqiten burime të ndryshme, saktësisht të prezantohen dhe të përpunohen informacionet, të shmangët të bindurit e gabuar të shikuesit, të respektohen të drejtat e njeriut për çdo person e kështu me radhë.

Këshilli miratoi rekomandim në vitin 2004 për veprime në rast konfliktesh ndërkombëtare³⁴, me të cilin prej operatorëve audioviziv kërkohet: ta kontrollojnë saktësinë e informacioneve dhe ta theksojnë burimin dhe datën e ngjarjes; në rast të përhapjes së informacioneve të pasakta, të publikohet korrigjimi; të merret parasysh, me vëmendjen dhe precizitetin e duhur, që te konfliktet ndërkombëtare ka mundësi që të nxiten tensione ose ato mund të rezultojnë me përjashtim ose ksenofobi e kështu me radhë.

Gjithashtu, CSA ka autorizime për të filluar procedurë pas ankesës së dorëzuar nga individë apo shoqata në lidhje me gjoja shkeljen e dispozitave nga Ligji për lirinë e komunikimeve ose të detyrimeve që janë ndërmarrë me kontratën për licencë. Në ueb-faqen e CSA janë publikuar disa raste, prej të cilave disa lidhen me shkeljen e dispozitave për respektimin e dinjitetit të njeriut:

- Në qershor të vitit 2014, CSA e paralajmëroi *Kanal +* - in (Canal+) për programin *Edizioni i ri (La Nouvelle Edition)* të datës 10 prill 2014, në të cilin gazetari ka dhënë komente të cilat kanë qenë me tendencë që ta minimizojnë shtrirjen e dhunave që kanë ndodhur në vitin 1992 në Maraga ndaj popullsisë armene. CSA konstatoi që deklaratat e tilla, qoftë edhe të jenë të shprehura me ton humoristik, nuk i marrin parasysh detyrimet sipas neneve 1 dhe 15 të Ligjit të datës 30 shtator 1986 në lidhje me respektimin e dinjitetit njerëzor³⁵.
- Në shkurt të vitit 2013, CSA nxori paralajmërim për *Frans 2 (France 2)* në lidhje me emisionin për ngjarje aktuale *Raportuesi special (Envoyé Special)* të datës 7 shkurt 2013. Sipas CSA, pamjet e paraqitura në magazin, në raportin kushtuar konfliktit në Mali, kanë përbërë shkelje të dinjitetit njerëzor të viktimave dhe do të kishin mundur t'i shqetësonin shikuesit e rinj. CSA e mbështeti vendimin e vet me faktin se pamjet që kanë treguar personat e vdekur kanë qenë të tejzgatura, janë përsëritur dhe në mënyrë eksplicite i kanë treguar trupat e viktimave. Në Sesionin e vet plenar, CSA vendosi të dalë me paralajmërim që redaktorët e *Frans-it* të mos i përsërisin

³⁴ Mund të shihet në: [http://www.csa.fr/related to en/Television/Le-suivi-des-programmes/La-deontologie-de-l-information-et-des-programmes/Les-fondements-juridiques](http://www.csa.fr/related%20to%20en/Television/Le-suivi-des-programmes/La-deontologie-de-l-information-et-des-programmes/Les-fondements-juridiques)

³⁵ Mund të shihet në: <http://www.csa.fr/en/Television/Le-suivi-des-programmes/La-deontologie-de-l-information-et-des-programmes/Chronique-dans-l-emission-La-Nouvelle-Edition-Canal-mise-en-garde>

kundërvajtjet e tilla³⁶. Paralajmërimi ishte nxjerrë mbi bazë të nenit 1 të Ligjit të datës 30 shtator 1986 për lirinë e komunikimeve dhe të nenit 16-1-1 të Kodit civil.

- Gjatë vitit 2003, kanali libanez *Al Manar* emetonte programe nëpër tërë Evropën pa licencë. Disa herë emetonte programe të ndryshme të cilat përmbanin elemente antisemitistike. Kanali ishte licencuar nga ana e CSA në nëntor të vitit 2004, me një kontratë jashtëzakonisht rigoroze, me detyrime që mos të emetojë përmbajtje diskriminuese ose çfarëdo formë tjetër qoftë të gjuhës së urrejtjes. Megjithatë, në dhjetor të vitit 2004, CSA mori vendim që t'i hiqet leja, pasi ndodhën disa kundërvajtje plotësuese. Gjithashtu, CSA menjëherë e dërgoi çështjen në gjykatën supreme franceze të gjyqësisë administrative (*Conseil d'État*), mbi bazë të nenit të ri 42-10 nga Ligji i ndryshuar i datës 30 shtator 1986, për ndërmarrjen e masave për ndërprerjen e riemëtimit të *Al Manar*-it përmes platformës satelitore *Eutelsat*³⁷. Gjykata Supreme konstatoi që, edhe krahas paralajmërimeve të nxjerra nga ana e CSA-së dhe pas nënshkrimit të kontratës me CSA-në, *Al Manar* ka vazhduar të emetojë program i cili dukshëm ka qenë në kundërshtim me dispozitat e nenit 15 të Ligjit të datës 30 shtator 1986, me të cilat ndalohet emetimi i programit që përmban nxitje të urrejtjes ose të dhunës mbi bazë të religjionit ose të nacionalitetit. Në të njëjtën kohë, CSA filloi procedurën e sanksionimit, e cila rezultoi me heqjen e kontratës më 17 dhjetor 2004.

³⁶ Mund të shihet në: <http://www.csa.fr/Television/Le-suivi-des-programmes/La-deontologie-de-l-information-et-des-programmes/Images-de-guerre-au-Mali-le-CSA-met-en-garde-France-Televisions>

³⁷ Shih më shumë detaje për rastin: <http://merlin.obs.coe.int/iris/2005/2/article21.en.html>

3. Polonia

3.1. Korniza kushtetuese dhe juridike

Kushtetuta polake përmban disa dispozita që lidhen me barazinë e të gjithë njerëzve para ligjit. Të gjithë njerëzit kanë të drejtën e trajtimit të barabartë nga ana e pushteteve publike. Askush nuk do të diskriminohet në jetën politike, shoqërore ose ekonomike për çfarëdo shkak qoftë (neni 32). Qytetarët polakë që u takojnë pakicave nacionale ose etnike janë të lirë që ta ruajnë dhe ta zhvillojnë gjuhën e tyre, t'i ruajnë zakonet dhe traditat dhe ta zhvillojnë kulturën e tyre. Pakicat nacionale dhe etnike kanë të drejtë të formojnë institucione arsimore dhe kulturore, institucione për mbrojtjen e identitetit fetar, si dhe të marrin pjesë në zgjidhjen e çështjeve që lidhen me identitetin e tyre kulturor (neni 91).

Kodi penal polak³⁸ i definon qartë gjuhët e ndryshme të urrejtjes dhe e ndalon nxitjen publike „të inicimit të agresionit luftarak“ (neni 117), dhe askush nuk guxon që publikisht të promovojë „... sistem totalitar fashist ose tjetërfare të shteteve ose të nxisë urrejtje mbi bazë të dallimeve nacionale, etnike, racore ose religjioze ose mbi bazë të mungesës së çfarëdo përcaktimi fetar“ (neni 256). Krahas kësaj, Kodi ka aktuar që askush nuk do të ofendojë publikisht „... ndonjë grup në kuadër të popullsisë ose ndonjë njeri të caktuar për shkak të përcaktimeve të tyre nacionale, etnike, racore ose fetare ose për shkak të mungesës së çfarëdo përcaktimi fetar“ (neni 257).

Gjuha e urrejtjes është e ndaluar edhe me Ligjin polak për radiodifuzion të vitit 1992³⁹, ku neni 18 akton që programet ose emetimet tjera „...nuk guxojnë të nxisin veprime kundër ligjit dhe *raison d'Etat*-it polak (interesi nacional)... e sidomos, nuk guxojnë të përfshijnë përmbajtje që nxit urrejtje ose diskriminim mbi bazë të racës, hendikepit, gjinisë, religjionit ose nacionalitetit“.

3.2. Autorizimet dhe praktikat e KRRiT në lidhje me gjuhën e urrejtjes

Trupi rregullator polak KRRiT (Krajowa Rada Radiofonii i Telewizji) është i autorizuar të bëjë monitorimin e përmbajtjeve të radiopërhapësve komercialë dhe publikë dhe të shqiptojë sanksione në shërbimet mediatike audiovizive për shkeljet e Ligjit për radiodifuzion (paralajmërimet, dënime dhe heqjen e kontratës). Në qoftë se radiopërhapësi nuk i përmbush detyrimet që janë të përcaktuara në nenin 18, kryesuesi i KRRiT-së do t'i shqiptojë vendim me dënim radiopërhapësit në shumë deri në 50% nga kompensimi vjetor për të drejtën e shfrytëzimit të frekuencës së ndarë për dhënien e shërbimit programor (neni 53).

³⁸ Mund të shihet në gjuhën angleze në: https://www.imolin.org/doc/amlid/Poland_Penal_Code1.pdf

³⁹ Mund të shihet në:

http://www.krrit.gov.pl/Data/Files/_public/Portals/0/angielska/Documents/Regulations/broadcasting_act_28022013.pdf

Në vitin 2012, pas parashtresës së dorëzuar nga dy qytetarë, KRRiT dënoi (me 50.000 zllota) një radiostacion të rokut nga Varshava – Eska rok SA (Eska Rock SA)⁴⁰ për emetim të programit satirik të mëngjesit, në të cilin gazetarët kanë dhënë deklarata raciste për qytetarët polakë me prejardhje indiane (Alvin Gaxhadhur). Programi ka qenë në lidhje me mbylljen e afërt të fushatës zgjedhore parlamentare. Gazetarët disa herë e kanë përsëritur emrin „Alvin Gaxhadhur“ duke përdorur atributin „i zi“ në kombinime frazeologjike shpeshherë të përdorura (kafe e zezë, humor i zi etj.) dhe ia kanë rikujtuar publikut se Gaxhadhuri i ka ofenduar para një kohe të caktuar dhe ka përhapur urrejtje. Në paraqitjen vijuese në program, gazetarët kanë dalë me mendimet e ekspertëve të cilët i kanë arsyetuar deklaratat e tyre të dhëna më parë në programin e drejtpërdrejtë. Si konkluzion, gazetarët e kanë lidhur natyrën negative të karakteristikave të një race të caktuar dhe e kanë theksuar diversitetin e racës dhe kualitetet e saj inferiore.

4. Bosnja dhe Hercegovina

4.1. Korniza kushtetuese dhe juridike

Kushtetuta e Bosnjë dhe Hercegovinës ishte miratuar si Aneks 4 i Marrëveshjes së paqes së Dejtonit dhe ka hyrë në fuqi me nënshkrimin në Paris më 14 dhjetor 1995. Me Kushtetutën e Bosnjë dhe Hercegovinës aktohet që BeH do të jetë shtet demokratik që funksionon sipas sundimit të së drejtës dhe me të pushtetet shtetërore dhe pushtetet e entiteteve marrin detyrimin që të sigurojnë nivelin më të lartë të të drejtave të njeriut dhe të lirive fundamentale ndërkombëtarisht të pranuar.

Dispozitat që lidhen me gjuhën e urrejtjes mund të gjenden në katër akte të ndryshme, të cilat janë pjesë e Kodit penal të Bosnjës dhe Hercegovinës. Janë këto neni 145a i Kodit penal të BeH, neni 163 i Kodit penal të Federatës së BeH, neni 294a i Kodit penal të Republikës Serbe dhe neni 160 i Kodit penal të qarkut Bërçko. Edhe pse të ndryshme për nga formulimet dhe shtrirja e tyre, të gjitha këto dispozita e ndalojnë gjuhën e urrejtjes në të katër juridiksionet e BeH-së.

Ligji për komunikime i Bosnjë dhe Hercegovinës e autorizon Këshillin e Agjencisë Rregullatore për Komunikime të nxjerrë akte nënligjore dhe kode për tema të ndryshme rregullatore. Kodi i shërbimeve mediatike audiovizive dhe i shërbimeve mediatike të radios⁴¹, miratuar nga ana e ARRK-ut në nëntor të vitit 2011, i zbaton dispozitat nga Direktiva për SHMAV në rregullativën ligjore nacionale. Në dispozitat e veta themelore në lidhje me parimet e përgjithshme programore (neni 3), Kodi qartë akton që shërbimet mediatike audiovizive dhe shërbimet mediatike të radios do të respektojnë dinjitetin e njeriut dhe të drejtat

⁴⁰ Mund të shihet në gjuhën polake në: http://www.krrit.gov.pl/Data/Files/_public/Portals/0/konsultacje/decyzja-eska-rock-2012-.pdf

⁴¹ Mund të shihet në: <http://rak.ba/eng/index.php?uid=1328108149>

fundamentale të të tjerëve dhe do të kujdesen që përmbajtja e tyre t'i respektojë dallimet etnike, kulturore dhe religjioze në Bosnjë dhe Hercegovinë. Më tej, në Kod është aktuar që dhënësit e përmbajtjes mediatike nuk do të japin përmbajtje që përfshijnë diskriminim apo paragjykime mbi bazë të gjinisë, racës, prejardhjes etnike, nacionalitetit, religjionit ose bindjes, hendikepit, nevojave të veçanta, moshës, orientimit seksual, prejardhjes sociale, ose të ndonjë përmbajtjeje tjetër e cila ka për qëllim apo për pasojë që ta pamundësojë ose ta rrezikojë njohjen, gëzimin ose realizimin, mbi bazë të barabartë, të të drejtave dhe lirive të cilitdo njeri (neni 3). Krahas kësaj, është theksuar që shërbimet mediatike audiovizive dhe të radios nuk do të transmetojnë materiale me rrezik të qartë dhe të drejtpërdrejtë të shkakimit të efekteve negative, përfshi, por pa u kufizuar, vdekjen, lëndimin, dëmin ndaj pronës apo ndonjë lloj tjetër të dhunës, ose pengimin e aktiviteteve policore, të shërbimeve medicinale apo të aktiviteteve të forcave të tjera të ruajtjes së rendit publik gjatë kryerjes së detyrimeve të tyre të rregullta (neni 3).

Kodi përmban një nen të veçantë me definicionin e detajuar për gjuhën e urrejtjes (neni 4). Dhënësit e shërbimeve mediatike audiovizive „nuk do të nënçmojnë apo të trembin dhe nuk do të nxisin dhunë apo diskriminim kundër njeriut apo grupit mbi bazë të gjinisë, racës, përkatësisë etnike, nacionalitetit, religjionit apo bindjes, hendikepit, nevojave të veçanta, moshës, orientimit seksual, prejardhjes shoqërore apo mbi bazë të ndonjë rrethane tjetër që ka për qëllim apo për pasojë që ta pamundësojë apo ta rrezikojë njohjen, gëzimin apo realizimin, mbi bazë të barabartë, të të drejtave dhe lirive të secilit njeri“. Në paragrafin e dytë, në nenin 4, është aktuar që shërbimet mediatike audiovizive „nuk do të transmetojnë material i cili në vete bart rrezik të qartë dhe të drejtpërdrejtë të nxitjes së urrejtjes etnike apo fetare në Bosnjë dhe Hercegovinë, apo të cilin publiku mund ta interpretojë si nxitje të dhunës, çrregullimit apo trazirave, apo i cili do të kishte mundur të shkakonte apo të nxiste vepra penale“.

4.2. Autorizimet dhe praktikat e ARRK në lidhje me gjuhën e urrejtjes

Agjencia Rregullatore e Komunikimeve - ARRK (Regulatorna agencija za komunikacije - RAK) është formuar në vitin 2001 dhe i ka ndërmarrë kompetencat e Komisionit të Pavarur për Media dhe të Agjencisë Rregullatore të Telekomunikimeve. Mandati i ARRK-ut është definuar me Ligjin e komunikimeve të Bosnjë dhe Hercegovinës si rregullator me kompetenca të lidhura, krijuar mbi bazë të modelit të rregullatorëve të ngjashëm në vendet tjera evropiane. Në sferën e radiodifuzionit, ARRK ka autorizime të qarta që të bëjë monitorimin e standardeve programore dhe të imponojë masa kundër dhënësve të shërbimeve mediatike audiovizive që nuk i respektojnë dispozitat nga Ligji i komunikimeve. Gjithashtu, Agjencia ka autorizime legjislative, përkatësisht mund të krijojë dhe të miratojë akte nënligjore (rregulla, kode etj.) të lidhura me standardet programore.

Dispozita e detajuar për gjuhën e urrejtjes në Kodin për shërbimet mediatike audiovizive i mundëson ARRK-ut që me themel të vlerësojë se a ka ndokund gjuhë të urrejtjes. Me këtë rast, ARRK e merr parasysh këtë në vazhdim: *burimin* e gjuhës së tillë, *kontekstin* në të cilin ajo është bërë e arritshme për publikun – gazetari/redaktori a ka theksuar që gjuha e tillë nuk e shpreh politikën e tyre redaktuese;

gazetari/redaktori a ka theksuar që gjuha e tillë e urrejtjes mund të ketë pasoja negative në shoqëri; apo, e kundërta, gazetari/redaktori ka dhënë koment i cili në mënyrë plotësuese e ka forcuar formën e tillë specifike të gjuhës së urrejtjes. Përgjegjësia e radiopërhapësve është më e madhe kur gazetari/redaktori duke e ditur, ose me qëllim provokon, ose përdor gjuhë të urrejtjes.

Gjer më tani, ARRK ka paraqitur disa raste të gjuhës së urrejtjes në mediat audiovizive:

- Në vitin 2012, ARRK ndërmoi masa⁴² kundër TV stacionit „TV Pink “ (BeH) në lidhje me emetimin e shout foljor me titull „Forum i ndaluar“ (Zabranet forum), të fokusuar në ndërrimin e gjinisë, gjatë të cilit porositë SMS janë treguar në ekran. Disa porosi SMS kanë pasur gjuhë ekstremisht diskriminuese plot me urrejtje, ndërsa në pajtim me Kodin e ARRK, radiopërhapësi është përgjegjës për tërë përmbajtjen, përfshi dhe porositë SMS të dërguara nga ana e publikut. ARRK vlerësoi që TV-stacioni është dashur që t'i parashohë pasojat nga diskutimi i një teme të tillë të ndjeshme dhe të organizohet ashtu që do t'i kontrollojë porositë për të penguar deklarata që do të kishin mundur të nxisnin urrejtje dhe dhunë. TV-stacioni ka refuzuar të marrë përgjegjësinë për kundërvajtjen, duke pohuar se roli i tij ka qenë vetëm t'i transmetojë porositë, gjë që e shtoi seriozitetin e kundërvajtjes. Disa muaj më vonë, TV-stacioni sërish e ka emetuar të njëjtin program TV, por tani me temë martesat homoseksuale. Sërish, porositë SMS me gjuhë provokative ishin transmetuar në ekran, por kësaj here një pjesë të porosive ishin lexuar nga ana e udhëheqësit të programit TV. Radiopërhapësi e pranoi kundërvajtjen e dytë, me arsyetimin se e njëjta është neglizhencë teknike.

⁴² Shih raportin vjetor të ARRK -ut 2012 në: <http://rak.ba/bos/index.php?uid=1272548169>

5. Irlanda

5.1. Korniza kushtetuese dhe juridike

Me nenin 40.1 të Kushtetutës së Irlandës është aktuar që „të gjithë qytetarët, si njerëz, do të jenë të barabartë para ligjit“. Me Ligjin që e ndalon nxitjen e urrejtjes, të vitit 1989, parashihen pesë kundërvajtje të ndryshme në lidhje me nxitjen e urrejtjes. Në këtë Ligj „urrejtje“ do të thotë „urrejtje ndaj grupit të njerëzve në shtet apo në vend tjetër mbi bazë të racës, ngjyrës, nacionalitetit, religjionit, përkatësisë etnike apo nacionale të tyre, përkatësisë ndaj grupit të ‘cergarëve’ irlandezë (‘travelling community’) apo të orientimit seksual“.

Në Ligjin për radiodifuzion të vitit 2009 është theksuar që çdo radiopërhapës do të kujdeset që çdo gjë e cila në mënyrë të arsyeshme mund të konsiderohet që shkakton ofendim apo kundërvajtje, apo se mund të promovojë apo të nxisë kryerje të veprës penale ose se është me tendencë që ta gërryjë autoritetin e shtetit, nuk do të emetohet nga ana e radiopërhapësit (pjesa 39d).

Pjesa 42 e Ligjit për radiodifuzion të vitit 2009 i jep urdhër Trupit Rregullator të Irlandës-BAI (Broadcasting Authority of Ireland – BAI) që t'i përgatit dhe t'i revidojë Kodet radiodifuzive me të cilat rregullohen standardet dhe praktikat të cilat do të duhet të respektohen nga ana e radiopërhapësve. Kodi për standardet programore⁴³ dhe Udhëzimet relevante⁴⁴ shqyrtojnë konceptin për shije, përshtatje, ofendim dhe kundërvajtje në lidhje me emetimin e radios dhe të televizionit.

Rregulla 3.4 e Kodit ka të bëjë me prezantimin e njerëzve dhe grupeve në shoqëri. Ajo akton që materiali programor nuk do të mbështet ose nuk do të kalojë përmes diskriminimit të ndonjë njeriu apo të një pjese të bashkësisë, e sidomos mbi bazë të moshës, gjinisë, statusit martesor, përkatësisë ndaj ‘cergarëve’ irlandezë, statusit familjar, orientimit seksual, hendikepit, racës ose religjionit. Krahas kësaj, radiopërhapësit janë të obliguar të pengojnë shkelje serioze në trajtimin e qëndrimeve, bindjeve ose pamjeve religjioze gjatë materialit programor, por kjo pa qëllimin që të pengohet studimi kritik i religjionit.

Rregulla 3.5 ka të bëjë me programet informative, me lajmet, me emisionet aktuale-informative dhe me filmat dokumentarë. Së pari është theksuar që programet informative nuk do të përmbajnë material që mund të dëmtojë respektimin e dinjitetit njerëzor. Pastaj, në nenin e njëjtë është theksuar që programet e këtilla nuk do të përmbajnë material që mund të shkaktojë shqetësim apo ofendim serioz, përveç nëse kjo nuk ka arsyeshmëri redaktuese dhe është në interes publik. Më tej aktohet që programet e këtilla do t'i theksojnë moshën, ngjyrën, gjininë, prejardhjen nacionale ose etnike, hendikepin, racën, religjionin apo orientimin seksual vetëm kur referencat e tilla janë të arsyeshme në kontekst të programit ose janë në

⁴³ Mund të shihet në: file:///C:/Documents%20and%20Settings/strpevska/My%20Documents/Downloads/bci_cops_Mar07.pdf

⁴⁴ Mund të shihet në:

file:///C:/Documents%20and%20Settings/strpevska/My%20Documents/Downloads/20070410_COPS_GuidanceNotes_vFinal.pdf

interes publik. Gjithashtu, personat e vdekur duhet të trajtohen me respekt. Momenti i vdekjes nuk do të tregohet, ndërsa personat e vdekur nuk do të tregohen nga afër, përveç nëse, në rrethana të veçanta, kjo mund të jetë e arsyeshme për shkak të interesit publik.

5.2. Autorizimet dhe praktikat e BAI në lidhje me gjuhën e urrejtjes

Për shkelje serioze dhe të përsëritura të Ligjit për radiodifuzion, të Kodit për standardet programore apo të dispozitave të kontratave për leje, trupi rregullator mund të imponojë sanksione financiare, ta suspendojë, bile dhe ta anulojë lejen. Komiteti për harmonizim i BAI mund të nisë hetime për punën e radiopërhapësit kur konsideron se ka rrethana të cilat sugjerojnë që është me vend të hulumtohet dhe të njoftohet çdo shkelje e qartë. Radiopërhapësi i zënë obligohet që të bashkëpunojë gjatë hetimeve të tilla dhe t'u sigurojë nëpunësve që e bëjnë hetimin informacione për të cilat ata konsiderojnë se janë të nevojshme në arritjen e objektivave të hetimit.

Po qe se Komiteti për harmonizim konstaton që ka shkelje nga ana e radiopërhapësit të zënë, mund t'i rekomandojë trupit rregullator që ta njoftojë radiopërhapësin. Në njoftimin e tillë theksohen shkaqet e njoftimit, theksohet që Trupi Rregullator synon t'i kërkojë Gjyqit që të konstatojë se është bërë shkelje dhe të theksojë shumën e sanksionit financiar (e cila nuk duhet të kalojë mbi €250,000) që propozon.

- Në janar të vitit 2013 – BAI e mbështeti parashtresën e Qendrës Botërore Galvej Uan (Galway One World Centre) kundër radiostacionit Klasik hits 4FM (Classic Hits 4FM)⁴⁵ ku pohohej që në shoun e Dejvid Harvit (David Harvey Show) komentet raciste kanë kaluar pa u kontestuar. Programi ka përfshirë diskutimin për një raport nga Instituti i Hulumtimeve Ekonomike dhe Shoqërore (ESRI) rreth asaj se njerëzit afrikanë që jetojnë në Irlandë a i nënshtrohen diskriminimit kur kërkojnë të punësohen. Komiteti i BAI-t ka ardhur në përfundim që, derisa ka rrjedhë programi, është lejuar emetimi i deklaratave nga ana e personave që janë paraqitur në program, të cilat ai i konsideron si raciste dhe të dëmshme: „zezakët“ janë „shumë dembela“, „afrikanët e zinj“ gjithnjë „mendojnë se janë më të mirë dhe më të mençur se të tjerët“, „zezakët“ kanë DNK të caktuar që lidhet me etikën dhe praktikat e punës së tyre, filipinasit në Irlandë janë „mashtues“ e kështu me radhë. Komiteti vendosi që në këtë rast radiopërhapësi nuk ka arritur që t'i plotësojë kërkesat ligjore dhe se dëgjuesit kanë mundur që arsyeshëm të supozojnë se vërejtjet raciste dhe paragjykimet e disa njerëzve që janë paraqitur në program janë qëndrime të arsyeshme dhe të pranueshme për shoqërinë bashkëkohore irlandeze.
- Në maj të vitit 2013 BAI mbështeti parashtresën kundër radiostacionit *Kork 96FM (Cork 96FM)* për shoun e Nil Prendevilit (Neil Prendeville Show)⁴⁶. Dëgjuesi ka kundërshtuar komentet e prezantuesit në lidhje me shtetasit e huaj gjatë një debati për pabarazinë në shoqëri, në programin

⁴⁵ Për më shumë detaje shih në: http://www.bai.ie/wordpress/wp-content/uploads/201310_October2013_vFinal.pdf

⁴⁶ Shih më shumë detaje në: http://www.bai.ie/wordpress/wp-content/uploads/CCECFDecisions_Sept2013_vFinal.pdf

e emetuar më 14 maj. Në parashtresë ishte theksuar që komentet e prezantuesit kanë qenë, sipas mendimit të tij, “akuza të liga, të lidhura me paragjykime dhe pa kurrfarë vërtetimi në realitet”. Në parashtresë ishte theksuar që, duke dhënë deklarata të këtilla në programe të drejtpërdrejta, prezantuesi “i vë në rrezik pjesëtarët jo-irlandezë të shoqërisë, duke i lidhur të njëjtët me atë çka ka ndodhur në këtë vend gjatë pesë viteteve të kaluara”. BAI pjesërisht e mbështeti parashtresën. Theksoi që komenteve të prezantuesit u ka munguar paanshmëria dhe objektiviteti dhe se për për të njëjtat nuk është siguruar qëndrimi i balancuar gjegjë nga perspektiva alternative.

9 Përfundime dhe rekomandime

- Direktiva për Shërbime Mediatike Audiovizive e thekson rolin e trupave rregullatorë të pavarur në sferën audiovizive në realizimin e rregullativës ligjore nacionale në të cilën janë mbartur rregullat nga Direktiva⁴⁷. Rregullatorët nga sfera e shërbimeve mediatike audiovizive nëpër tërë Evropën kanë autorizim që të bëjnë mbikëqyrjen e harmonizimit të programeve audiovizive me rregullativën ligjore nacionale, e cila është sinkronizuar me Direktivën për Shërbime Mediatike Audiovizive.
- Në nenin 6 të Direktivës për Shërbime Mediatike Audiovizive është theksuar që „pushtetet në çdo vend-anëtar patjetër të angazhohen, me mjete adekuate, që shërbimet mediatike audiovizive të siguruara nga ana e dhënësve të shërbimeve mediatike nën kompetencë të tyre të mos përmbajnë çfarëdo nxitje të urrejtjes mbi bazë të racës, gjinisë, religjionit ose nacionalitetit”. Pushtetet në çdo vend të BE-së patjetër të kujdesen që shërbimet mediatike audiovizive të mos përmbajnë kurrfarë nxitje të urrejtjes mbi bazë të racës, gjinisë, religjionit ose nacionalitetit. Ata duhet të veprojnë kundër kanaleve që shfrytëzojnë lidhje satelitore (uplink) në një vend të BE-së dhe kapacitet satelitor që shfrytëzohet për emetimin e gjuhës së urrejtjes nga ana e kanaleve të licencuara në vende të tjera të BE-së.
- Gjatë konstatimit të gjuhës së urrejtjes, më shumë trupa rregullatorë në vendet evropiane⁴⁸ si parime udhëheqëse i shfrytëzojnë shembujt nga e drejta precedente e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të gjykatave vendore. Rregullatorët audiovizivë kanë në dispozicion sanksione prej më të ndryshmeve: vërejtje, urdhër për publikimin e gjetjeve të rregullatorit, urdhër për publikimin e korigjimit, dënime financiare dhe, në raste shumë serioze, vendim për shkurtimin apo heqjen e lejes.
- Definicioni në Ligjin për shërbime mediatike audiovizive është harmonizuar me nenin 6 të Direktivës për Shërbime Mediatike Audiovizive dhe me nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Megjithatë, mbetet çështja kryesore – fakti që ASHMAAV nuk ka masa të mjaftueshme reagimi kur ka nevojë të pengohet „gjuha e urrejtjes“ në mediat audio dhe audiovizive. Për këtë shkak, ende ka hapësirë për përparim për t'i mundësuar Agjencisë që të ketë më shumë kompetenca në luftimin e gjuhës së urrejtjes në praktikë.
- Siç e përcakton Artikulli 19, „shteti duhet të aplikojnë mjete të ndryshme juridike, përfshi masat civile, administrative dhe të tjera, të cilat e ndalojnë nxitjen. Aplikimi i dënimeve nga Kodi penal duhet të kufizohet vetëm tek format më serioze të nxitjes”. Njëkohësisht, Artikulli 19 përfundon që „kjo nuk është rast në të shumtën e shembujve aktualë”.

⁴⁷ Shih më shumë detaje në: <http://ec.europa.eu/digital-agenda/en/avmsd-audiovisual-regulators>

⁴⁸ Projekt-dokument informativ i i EPRA: Rezume në përgjigjet e Pyetësorit për gjuhën e urrejtjes (Summary of the Answers to the Hate Speech Questionnaire), paraqitur në Sesionin 2 plenar: *Gjuha e urrejtjes – armik i vjetër, beteja të reja* (Hate Speech – Old Enemy, New Battles), Takimet e 39-ta të EPRA-s; Budva, 3-6 qershor 2014.

- Gjithashtu, duhet të theksohet që Artikulli 19 rekomandon që “të merren parasysh sanksionet administrative, sidomos për t’u zbatuar rregullat e vëna nga ana e këshillave për komunikime, media dhe shtyp, trupat për mbrojtjen e konsumatorëve ose cilëtdo trupa të tjerë rregullatorë”.
- Me rëndësi është që Agjencia të vë bashkëpunim me Komisionin për Mbrojtje nga Diskriminimi në pajtim me Ligjin për mbrojtje nga diskriminimi. Mund të jetë me efikasitet në qoftë se përgatitet dhe nënshkruhet Memorandum për bashkëpunim, i cili do t’i definojë kompetencat e të dyja agjencive në pajtim me të dy ligjet.
- Bashkëpunimi midis shoqatave të gazetarëve, trupat vetë-rregullatorë, OJQ-të dhe institucionet e larta të arsimit është me rëndësi të jashtëzakonshme për temat që lidhen me „gjuhën e urrejtjes“, me qëllim zhvillimin e mbrojtjes së tërësishme dhe të koordinuar nga diskriminimi mbi baza të ndryshme.

Përkthimi & redaktimi gjuhësor: Nazif Zejnullahu